



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS

**ANALIZA E PUNËS
E GJYKATËS TË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS
GJATË VITIT 2024**

DURRËS, 24 JANAR 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM Durrës

Nr. ____ Prot.

Durrës, më _____.____.2025

**ANALIZA E PUNËS E GJYKATËS TË SHKALLËS SË PARË
E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM Durrës
GJATË VITIT 2024**

HYRJE

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës paraqet raportin vjetor për veprimtarinë e saj për 2024. , duke paraqitur një analizë të punës e të gjithë strukturave përbërëse të saj, me qëllimin e rezultateve të arritura, përpjekjeve, sfidave dhe kapërcimit të hasura.

Materialin vijues përmban në mënyrë të përmbledhur veprimtarinë e trupës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të dhëna statistikore të veprimtarisë gjyqësore, pasqyrimin e aktiviteteve të brendshme dhe të jashtme të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës gjatë vitit kalendarik 2024 si dhe problematikat e hasura për sa i takon funksionimit të institucionit në tërësi.

Gjithashtu, në këtë material do të trajtohen përballja e një ngarkese të madhe të punës gjatë këtij viti që kaluam , treguesit që lidhen me performancën në menaxhim dhe në vendimmarrje, sfidat dhe problematikat e hasura gjatë veprimtarisë administrative -gjyqësore të vitit 2024.

Në këtë analizë të punës së Gjykatës tonë do të trajtohen edhe aspekte që lidhen me infrastrukturën, teknologjinë dhe shërbimet administrative të ofruara, elementë këta që gjithashtu vlerësohen të kenë ndikim në performancën e gjykatës.

Në funksion të analizës, treguesit e punës do të trajtohen në referim të punës së bëra nga të gjithë sektoret e gjykatës , konkretisht në këto drejtime:

Volumi i çështjeve civile dhe penale për gjykim gjatë vitit 2024;

1. Shpejtësia në gjykim;
2. Burimet njerëzore dhe prokurimet e gjykatës
3. Financat dhe buxheti
4. Arkiva
5. Marrëdhëniet me institucionet e tjera me të cilat lidhet puna e gjykatës, etj.

Edhe gjatë vitit 2024 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është përpjekur që të garantojë zhvillimin e një procesi të rregullt gjyqësor

Organika e miratuar e Gjykatës tonë, pas riorganizimit në referim të Vendimit Nr. 151, datë 29.03.2023, sipas shtojcës Nr. 1, të Këshillit të Lartë Gjyqësor përbëhet nga 77 (shtatëdhjetë e shtatë) punonjës, në të cilën 23 (njëzet e tre) janë gjyqtarë dhe 54 (pesëdhjetë e katër) punonjës të tjerë.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ka në përberjen e saj 4 (katër) sektore, konkretisht;

- Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë (1+3);
- Sektori i Buxhetit dhe Manaxhimit Financiar (1+1+2);
- Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve (1+13);
- Sektori i Protokollit, Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit (1+3+3).

Trupa gjyqësore e Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në 4 mujorin e fundit të vitit 2024, u shtua dhe me 6 (gjashtë) gjyqtarë. Kjo solli që Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në veçanti mbas muajit shtator 2024 të punonte me kapacitet me të plotë, ç'ka solli natyrshëm dhe një rritje të numrit të çështjeve të shqyrtuara.

Gjykata jonë ka vijuar të përballet edhe gjatë vitit 2024 me një ngarkesë të madhe në punë.

Përgjatë vitit 2024, me Vendimin Nr 44 datë 23.07.2024, Këshilli i Gjykatës vendosi bashkimin e seksionit civil dhe penal në një seksion të vetëm, duke bërë njëkohësisht dhe shpërndarjen e gjyqtareve në trupa gjyqësorë. Kjo vendimarrje erdhi si rezultat i lindjes së rrethanave të reja, sipas organikes të gjykatës ku duhet të ushtrojnë detyrën 23 (njëzet e tre) gjyqtarë e nderkohe aktualisht në fund të muajit korrik 2024 ishin 11 (njëmbëdhjetë) gjyqtarë që ushtronin detyrën, Këshilli i Gjykatës e pa të arsyeshme për të marrë një vendimarrje për shkak të mbarevatjes së punës, efikasitetit dhe manaxhimit sa më të mirë të çështjeve, vetëm me trupën gjyqësore aktuale.

Perseri ky bashkim ndikoi tek gjyqtarët dhe administrata gjyqësore duke sjellë jo vetëm një ngarkesë shumë të madhe për t'u përballuar nga trupa gjyqësore, por njëkohësisht dhe një shpërqendrim të gjyqtareve të cilët i duhet të gjykonin nga një seancë gjyqësore penale menjëherë më pas në një seancë gjyqësore civile

Nderkohe me largimin e gjyqtarës Shpetime Pitaku Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës mbeti me 10 (dhjetë) gjyqtarë, çka bëri që ngarkesa midis gjyqtareve të ishte akoma dhe më e madhe.

Por pas këtij momenti, Këshilli i Lartë Gjyqësor mori vendimin Nr 471, 472, 473, 474, 475, dhe 476 datë 31.07.2024 duke transferuar me pelqimin e tyre pranë gjykatës sone 6 (gjashtë) gjyqtarë, me efekte juridike nga data 11.09.2024.

Ne keto kushte, me Vendimin Nr. 63 date 16.09.2024 , Keshilli i Gjykates vendosi shperndarjen e gjyqtareve te Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshme Durrës ne dhoma , seksione dhe trupa gjykues.

KËSHILLI I GJYKATËS

Referuar Ligjit Nr. 98/2016 “*Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor ne Republiken e Shqiperisë*”, administrimi gjyqësor ne gjykate është detyre e Keshillit te Gjykatës, Kryetarit të Gjykatës, Kancelarit dhe kategorive te ndryshme te nëpunësve civile gjyqësor.

Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshme Durrës mbështetur në pikën 17 të Vendimit Nr.71, datë 20.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “*Për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës*” në fillim të vitit miraton kalendarin për mbledhjet mujore, por që krahas tyre mbledhjet zhvillohen edhe jashtë këtij kalendari të miratuar, për shkak të vendimarrjeve të ndryshme

Keshilli i Gjykatës gjatë vitit 2024 ka qenë i perberë nga Zv. Kryetari Gjyqtari me i vjetër ne detyrë dhe Kancelari. Gjatë vitit eshte larguar si anetare e Keshillit Z. Shpetime Pitaku duke u zevendesuar me Z. Rexhep Bekteshi.

Per vitin 2024 janë dhënë gjithsej 82 (tetedhjet e dy) vendime nga Këshilli i Gjykatës.

Përsa i takon administrimit të gjykatës, Këshilli i Gjykatës edhe përgjatë vitit 2024 ka vepruar si një ekip drejtues kolegjal. Në punën e tij ai ka qenë në rolin e një drejtuesi duke ndihmuar në arritjen e objektivave të gjykatës si tek vendosja e besueshmërisë së publikut në cilësinë e drejtësisë dhe pa vonesa, në rritjen e aksesit, si dhe në garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Problematikat dhe çështjet janë diskutuar nga të tre anetarët në takimet që ka zhvilluar Keshilli i Gjykatës. Keto diskutime i kanë paraprire gjithë procesit të vendimarrjes, duke filluar nga analiza e situatave të paraqitura përpara Këshillit, shkaqet që kanë sjellë këtë situatë, nga diskutimi paraprak në këshill dhe së fundmi për mënyrën e drejtë të mundshme të zgjidhjes së problemit.

Por vendimarrja me e rendesishme e Keshillit te Gjykates ka qene Vendimi Nr 67 date 20.09.2024 “Mbi Akomodimin e Dhomes Civile te Gjykates se Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe stafit mbeshtetes ne godine e ish Gjykates se Apelit Durres”

Nderkohe në vendimarrjen e Këshillit kanë patur iniciativë disa lloj shkaqesh konkretisht:

- Problematikat e hasura në menaxhimin e përditshem të punës të cilat kanë patur nevojë për t’u zgjidhur nga ana e Këshillit me Vendimarrje.
- Vendimarrje në lidhje me rekrutimet e reja, me procesin e rekrutimeve të reja, ku ligji përcakton një procedurë me disa hallka në lidhje me këto rekrutime. (sqarojmë këtu se

proçesi i rekrutimeve, duke patur parasysh edhe hapat që duhet të ndiqen kërkon njohuri të veçanta në lidhje me mënyrën e intervistimit, pikëzimin dhe vlerësimin e kandidatëve, proçesi i cili nga të gjithë anëtarët i është kushtuar një rëndësi e veçantë.)

- Vendimmarrje me natyrë financiare apo menxhim financiar të fondeve të buxhetit dhe fondeve të vetë institucionit. (Miratimi i PBA)

Viti 2024 ka qenë një vit i vështirë dhe i ngarkuar në punë, jo vetëm për trupën gjyqësore dhe administratën e gjykatës për përballimin e ngarkesës së punës, por në veçanti për Këshillin e Gjykatës, i cili ka pasur rolin kryesor në organizimin e punës në ndarjen e dy Seksioneve Penale e Civile në dy godina të ndryshme por dhe në mënyrën e administrimit të punës në këto dy godina.

Pergjate vitit 2024, puna me e rendesishme e Keshillit te Gjykatës, ka qene puna mbi masat e mara per administrimin e godines se ish Gjykates Apelit Durres në zbatim të hartës së re gjyqësore, konkretisht në referim të Marrëveshjes Nr. 4814/1 Prot., datë 26.09.2023, midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorisë së Përgjithshme, ku u parashikua se Seksioni Civil i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës do të transferohej pranë godinës të ish-Gjykatës së Apelit Durrës.

Masat janë marrë se pari për kalimin në përgjegjësi administrimi të ish-godinës së Gjykatës së Apelit Durrës, në favor të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, dhe njëkohësisht për funksionalizimin e infrastrukturës me qëllimin e transferimit të Dhomës Civile brenda standardeve dhe garancive të parashikuara e burime njerëzore aktuale.

Një rol të madh e të rëndësishëm për të matur cilësinë, efikasitetin e shërbimeve kanë shërbyer të dhënat statistikore përgjatë punës së Këshillit të Gjykatës. Analizimi i tyre ka qenë mjaft i rëndësishëm në gjetjen e informacioneve të nevojshme, konkretisht në ngarkesën e gjyqtarëve, kohëzgjatjen e nevojshme të zgjidhjes së çështjes, sasinë e burimeve njerëzore etj.

Këshilli i Gjykatës i ka përdorur këto të dhëna në të njëjtën kohë dhe për nevojat për të përmirësuar nivelin dhe cilësinë e shërbimit. Njëkohësisht të dhëna statistikore kanë qenë të rëndësishme dhe në diskutimete mbledhjeve me gjyqtarët, duke qenë një tregues mbi ngarkesën e cdo gjyqtari.

Një tregues me rëndësi për performacën e punës së gjykatës tonë, ka qenë dhe përdorimi i 2 indikatorëve të (CEPEJ) që janë Clearance Rate (CR indikator) i cili tregon raportin midis çështjeve të regjistruara me çështjet e përfunduara në përqindje dhe Disposition Time (DT) i cili tregon raportin e shpejtësisë së përfundimit të çështjeve gjyqësore të ardhura në gjykatë në ditë

INFRASTRUKTURA

Vlerësojmë se është e rëndësishme të theksohet që në fillim se pavarësisht faktit se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ne referim te Vendimit Nr. 147 datë 29.03.2023 “Për përcaktimin e kategorivetë Gjykatave”, është gjykata e kategorise se dytë, ajo nga numri i çështjeve qe gjykon është tek gjykatat e kategorise se parë dhe nje nder gjykatat me infrastrukture jashtë çdo parametri dhe standardi për ushtrimin e funksionit të dhënies së drejtësisë.

Me implementimin e Hartës së Re Gjyqësore dhe me bashkimine dy gjykatave, lindi domosdoshmeria e një godine te re.

Përsa i perket ambjentet aktuale të godines ekzistuese të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, mund të themi se janë të pamjaftueshme për ushtrimin e detyrës si nga ana e gjyqtarëveashtu dhe administratës gjyqësore për garantimin e transparencës, trajtimit dinjitoz e solemn të qytetarëve në kërkesat e tyre apo seancat gjyqësore

Gjendja e godinës paraqitet tejet e amortizuar. Ambientet kanë lagështirë dhe muret janë të dëmtuara si në ambientet e jashtme, ashtu edhe në ato të brendshme të gjykatës.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka vetëm 4 salla gjykimi: nga një sallë në katin e parë dhe të dytë dhe dy salla në katin e tretë. Një nga këto salla përdoret ekskluzivisht vetëm për gjykime penale me të pandehur në gjendje arresti, për shkak të mungesës së sigurisë në sallat e tjera, ndërsa tre sallat e tjera përdoren nga të gjithë gjyqtarët sipas planifikimeve të kryera nëpërmjet kalendarit elektronik.

Pavarësisht se përdorimi i sallave të gjykimit rezulton të jetë maksimal, në shumicën e rasteve nga ora 08:30 – 16:00, është lehtësisht e kuptueshme që numri i sallave të gjykimit nuk plotëson ngarkesën e çështjeve që gjykohen në Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Për këtë shkak ende numri më i madh i gjykimeve zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve.

Garantimi i sigurisë së gjyqtarëve në godimen e Gjykatës tonë është tejet i ulët , pasi gjykimi në këto salla nuk e garantojnë këtë siguri për arsye të madhësisë, pikëpamjes teknike dhe pozicionimit të tyre . dy nga sallat e gjykimit nuk kanë as dhomë këshillimi dhe gjyqtarët kur hyjnë dhe dalin në sallë ndodhen në të njëjtin ambient me qytetarët, çka nuk garanton as nivelet minimale të sigurisë të gjyqtarëve. Shkallët janë të përbashkëta, si për gjyqtarët, ashtu edhe për qytetarët.

Njëkohësisht ky mosgaratim sigurie të niveleve minimale është jo vetëm për gjyqtarët por dhe për të gjithë punonjësit e tjerë të administratës gjyqësore.

Parkimi i pasëm i gjykatës ka kapacitet vetëm për 5-6 automjete, çka bën që gjyqtarët dhe administrata të parkojnë në ambiente të jashtme të gjykatës, në të cilat nuk mund të garantohet siguria.

Në lidhje me shërbimin e sigurisë, sipas legjislacionit në fuqi nga Komisariati i Policisë Durrës ofrohet asistencë me një punonjës policie në orarin 08:00 – 15:00, ndërkohë nga ora 15:00 – 08:00 të ditës pasardhëse shërbimi i sigurisë ofrohet nga shoqëria private “Illrian Guard “ Sh.A,. Për përcaktimin e rregullave, detyrimeve reciproke dhe përgjegjësi, është nënshkruar një Rregullore e Përbashkët e Sigurisë ndërmjet titullarit të Gjykatës dhe Shoqërisë Private.

Sa i takon shërbimeve të ofruara qytetarëve nga ana jonë janë është përshtatur një sportel ku ofrohen shërbimet e kryesekretarisë dhe shërbimet e tjera si: tërheqja e vërtetimeve, kopjeve të akteve apo vendimeve gjyqësore, etj. Ndërsa shërbimet e financës kryhen brenda gjykatës për shkak të pamundësisë fizike të ambienteve ku të përshtaten sportele për orfinimin e shërbimeve. Kushtet e godinës ndikojnë dhe në ofrimin cilësor të shërbimeve të kërkuara nga qytetarët, pavarësisht synimit dhe vullnetit të administratës gjyqësore.

Referuar Marrëveshjes Nr. 4814/1 Prot datë 26.09.023, midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorisë së Përgjithshme është parashikuar se Seksioni Civil i Gjykatës tonë do të transferohet pranë godinës të ish-Gjykatës së Apelit Durrës. Për këtë arsye nga ana e Zv. Kryetarit të Gjykatës në bashkëpunim me Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokurorinë e Përgjithshme dhe me KLGJ-në, është organizuar gjate vitit 2024 procesi i punës për marjen në dorëzim të godinës dhe aktiveve të saj.

Konkretisht, në mënyrë kronologjike hapat dhe masat e marra për zbatimin dhe funksionalizimin e ish-godinës së Gjykatës së Apelit Durrës, kane filluar ne fund te vitit 2023 duke u finalizuar ne fund te muajit Shtator 2024.

Keshtu në referim të Marrëveshjen Nr. 4814/1 Prot., datë 26.09.2023, se pari lindi e nevojshme inventarizimi i aktiveve të godinës së ish-Gjykatës së Apelit Durrës me qëllimin e vijimit të punës për transferimin e Seksionit Civil të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në këtë godinë.

Për këtë arsye, ne fund te vitit 2023, me anë të shkresës Nr. 6046 Prot., datë 09.11.2023, “*Mbi inventarizimin e aktiveve të ish-Gjykatës së Apelit Durrës*” me iniciativë të Zv/Kryetarit të Gjykatës Z. Paulin Çera, ju kërkua Prokurorisë së Përgjithshme, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës mbi caktimin e një përfaqësuesi për të marrë pjesë në inventarizimin e aktiveve të ish-godinës së Apelit Durrës dhe më pas me vijimin e procedurave sipas ligjit. Njëkohësisht duke qenë se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë kishte ambjente zyre shërbimi në ish-godinën e Gjykatës së Apelit Durrës me shkresën Nr. 507 Prot., datë 16.11.2023 u vlerësua nga ana e Zv/ Kryetarit të Gjykatës të kërkohej dhe nga kjo gjykatë në caktimin e një përfaqësuesi mbi pjesmarjen e një përfaqësuesi për të marrë pjesë në inventarizimin e aktiveve të ish-godinës.

Në zbatim të shkresave të sipërcituata të “*Mbi inventarizimin e aktiveve të ish-Gjykatës së Apelit Durrës*”, u mbledhën përfaqësues të Gjykatave me qëllimin e evidentimit të aktiveve fizike të ish-godinës së Gjykatës së Apelit Durrës.

Në referim të shkresës Nr. 457/3 Prot., datë 23.01.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “*Mbi administrimin e godinave të gjykatave, në zbatim të hartes së re gjyqësore*”, me Urdhër Nr. 67 Prot., datë 05.03.2024 të Zv/Kryetari i Gjykatës Z. Paulin Çera, u urdhërua ngritja e një grupi pune për kalimin në përgjegjësi administrimi të ambjentëve të ish Godinës së Apelit Durrës.

Në vijim të procesit për kalimin në përgjegjësi të ish-godinës së Gjykatës së Apelit Durrës në favor të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në referim të Urdhrit Nr. 67 Prot., datë 05.03.2024 të Zv/Kryetari i Gjykatës Z. Paulin Çera, Urdhrit Nr. 2150 Prot., datë 02.02.2024 të Zv/Kryetares Znj. Valdete Hoxha të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Urdhrit Nr. 22, datë 29.01.2024 të Zv. Kryetarit Bezart Kaçkini të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë u mbajt Proçes – verbali Nr.73/4 Prot., datë 06.03.2024, në ambientet e ish-Gjykatës së Apelit Durrës, në prani të grupeve të punës të ngritura nga urdhërat e sipërcitura të Zv /Kryetaresve të tre Gjykata. Gjithashtu u bë dorëzimi dhe i sallave të gjykimit.

Njëkohësisht u dakordësua midis palëve që njërin nga sportelet në Zyrën e Informacionit që ishte sipas Vendimit Nr. 28, datë 11.10.2022 të Këshillit të Gjykatës së Apelit Durrës nga ana e Zyrës së Shërbimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (ambient i përbashkët me Zyrën e Shërbimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë) ju dha me marrëveshje Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për përdorim.

Ndërkohë zyra e Serverit, e ndodhur në katin e tretë të godinës dhe e administruar nga specialistët e IT të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, ende nuk është marrë në administrim nga ana e Gjykatës sonë.

Ndërkohë përgjate vitit 2024 nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës u ndërmorën dhe një një sërë hapash të tjera të nevojshëm për funksionalizimin e infrastrukturës së ish-Godinës së Apelit Durrës me qëllimin e transferimit të Dhomës Civile brenda standardeve dhe garancive të parashikuara.

Për shkak të mungesës në organikë me gjyqtar, nuk u vlerësua kalimi i seksionit civil në ish godinën e Gjykatës së Apelit Durrës. Por dihej që me shtimin e organikës, ushtrimi i veprimtarisë në godinë aktuale do të bëhej tejet i vështirë.

Duke pasur në vëmendje sa më sipër, nga ana e Zv/Kryetarit të Gjykatës, Kancelares dhe Specialistit të IT është bërë kqyrja fizikisht e këtyre ambienteve të godinës së ish-Gjykatës së Apelit Durrës. Nga kqyerja rezultojë se këto ambiente nuk ishin funksionale, me mure të rënda, dysheme të dëmtuar, salla gjykimi pa pajisje dhe logjistikë përkatëse etj. Në këto kushte, me qëllim evidentimin e saktë të mungesave në bazë materiale apo pajisje elektronike, u kontraktua

Ing. Ardian Naqellari i cili pas kqyrjes fizike, përpiloi Relacion Teknik *“Ndërhyrje përmirësuese tek godina e Ish-Gjykatës së Apelit Durrës”* shoqëruar edhe me Preventivin përkatës.

Gjate procesit të marjes në dorezim u konstatuan shumë probleme për mirfunksionimin të godines, ku konkretisht disa pajisje elektronike psh: kompjuterat nuk ishin funksionalë ose nuk ishin sipas parametrave të përcaktuara nga QTI. Mungonin kompjuterat për sallat gjyqësore, UPS dhe Mixer sipas parametrave të përcaktuara nga Standardet Teknike *“Mbi specifikimet minimale teknike për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në institucionet e sistemit të drejtësisë”* nga QTI.

Gjithashtu, u konstatua se rrjeti i brendshëm dhe I linjës së internetit nuk funksiononte me shpërndarje të drejtpërdrejtë nga Dhoma e Serverit (si duhet të ishte) por ishte e degëzuar me disa ndarje dhe shpërndarje nëpërmjet pajisjeve SWITCH plug & play (16 porta). (Sikundër dihet funksionimi i shpërndarjes së rrjetit është i një rëndësie kyçe për ushtrimin e detyrave dhe të gjithë veprimtarisë administrativo-gjyqësore nga nëpunësit e Gjykatës).

Gjithashtu dhe Switchet ishin të vendosura fizikisht 1 (një) tek paradhoma e Kryetarit, 1 (një) në katit të parë, dhe 1 (një) në hollin e katit të tretë. Kjo mënyrë shpërndarje nuk përmbushte garancitë minimale të sigurisë dhe nuk ishte sipas standardeve të përcaktuara nga QTI. Shpërndarja në këtë mënyrë përveç faktit që nuk ishte sipas standardeve të përcaktuara, por mund të sillte problematika gjatë veprimtarisë në punën e përditshme të administratës.

Duke qenë se në godinën e ish-Gjykatës së Apelit Durrës ushtronin aktivitetin edhe 2 (dy) zyra shërbimi, përkatësisht zyra e shërbimit të Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Tiranë dhe zyra e shërbimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për arsye sigurie duhet të bëhej i mundur edhe segmentimi i rrjetit me qëllim që rrjeti jonë të mos aksesohet nga kompjuterët e zyrave të shërbimit. Ndërhyrja e rregullimit të infrastrukturës së shpërndarjes së rrjetit të brendshëm u bë e domosdoshme pasi do të kthente në gjendje funksionale dhe sipas parametrave dhe standardeve të përcaktuara godinën e ish-Gjykatës së Apelit Durrës.

Referuar situatës që ndodhej kjo godine, me shkresën Nr. 4099 Prot., datë 18.06.2024, Zv/Kryetari i Gjykatës i është drejtuar KLGJ-së mbi një kërkesë për fonde për plotësimin e nevojave për bazë materiale aktualisht në mungesë me qëllim funksionalizimin e godinës së ish-Gjykatës së Apelit Durrës dhe transferimin e Dhomës Civile.

Nga ana e Klgj-se në korrik 2024 u pranua kërkesa e jone për fond. Me ardhjen e fondit për rikostruksionin e ish godines se Gjykatës se Apelit si dhe me shtimin në organike të 6 (gjashte) gjyqtarve me datë 31 Korrik u vlerësua kalimi urgjent i Seksionit Civil në ish godinën e Gjykatës së Apelit Durrës.

Me fillim të muajit Gusht 2024, mbi bazën e Relacion Teknik *“Ndërhyrje përmirësuese tek godina e Ish-Gjykatës së Apelit Durrës”* të shoqëruar me Preventivin përkatës u zhvillua procedura e prokurimit me objekt *“Rikostruksioni godinës së ish-Gjykatës së Apelit Durrës”*, ku punimet mbaruan në fillim të muajit shtator 2024.

Gjate kohes te rikostruksionit te godines, si dhe duke pare dhe kushtet e zyrave dhe te ambjenteve ku do te ushtronte veprimtarine Seksionit Civil, u pa e arsyeshme nga ana e Zv/Kryetari i Gjykatës Z. Paulin Çera te arrihej ne nje mareveshje mbi pjesen e sportelit ne kete godinë.

Per kete arsye me shkresen Nr. 5045 Prot. datë 06.09.2024.” ju drejtua Zv/Kryetares Znj. Valdete Hoxha të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Zv. Kryetarit Bezart Kaçkini të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë mbi vlerësimin e një marëveshje midis institucioneve të cilat ushtrojnë veprimtarine në të njëjtën godinë, duke ju kërkuar në arritjen e një dakortesie mbi lirimin e sportelit në Zyrën e Informacionit që është përdorur nga Zyra e Shërbimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky propozim nga ana e Zv/Kryetari i Gjykatës Z. Paulin Çera mori shkas nga ngarkesa e madhe qe ka ne dhenien e sherbimit ne sportel gjykata e jone e per rrjedhoje nevojën e pasjes te nje hapësire me te madhe ne sportel.

Si rezultat u arrit dakortesia midis tre institucioneve ku sporteli i Zyrës së Shërbimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë u kalua në dy zyrat e katit të parë, ish-Zyra e Finaces (e cila aktualisht ishte në përdorim nga Zyra e Shërbimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë) dhe ish Zyra e Kancelares e cila aktualisht ishte në administrim të së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Nderkohe ju propozua dhe u dakortesua qe pas lirimit te Zyres ne katin e pare te godines (e cila aktualisht është në përdorim nga Zyra e Shërbimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë), kesaj zyre sherbimi ju propozua dhe ju dha nje zyre ne katin e katert te godines.

Si rezultati kesaj mareveshje u mbajt proces- verbali më datë 13.09.2024, *“Për kalimin në përgjegjësi të ish godinës së Gjykatës së Apelit Durrës në favor të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas shkresës nr. 5045 Prot. datë 06.09.2024.”* me ane te se ciles u bene kalimet e zyrave sipas mareveshjes ne shkresën nr. 5045 Prot. datë 06.09.2024, e njekohesisht u be dhe dorezimi i aktiveve të katit te pare te godines.

Aktualisht për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nga ish-Godina e Apelit Durrës janë marrë në dorëzim keto zyra , të ndara si më poshtë:

Gjykata Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës:
18 zyra , 4 salla , holli i mbledhjes dhe banjo

Gjykata Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë :
1 zyre Sherbimi , 2 zyra arkive dhe 1 zyrë e serverit

Gjykata Administrative Tirane:
1 zyrë Sherbimi dhe 4 zyra arkive

Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Organika e Sektorit të Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për vitin 2024 përbëhet nga 4 punonjës, 1 Shefe Sektori Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, 1 specialiste finance, 1 specialiste buxheti dhe 1 magazinierë. Organizimi kjo e cila ka ndryshuar me implementimin e Hartës së Re Gjyqësore dhe në zbatim të rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Në këtë Sektor gjatë vitit 2024 ka pasur ndryshime nga viti i mëparshëm në lëvizjen e punonjësve duke u shtuar një pozicion, atë të Specialistes së Buxhetit. Ky pozicion u plotësua në muajin Maj 2024.

Aktualisht në këtë sektor ka një pozicion vakant, për shkak të miratimit të dorëheqjes dhe largimit të specialistes së buxhetit.

Gjatë vitit 2024 kjo strukturë, në ndjekje të detyrave të saj administrative dhe financiare ka arkëtuar për interes të Buxhetit të Shtetit të ardhurat në formën e taksave të padive dhe taksat mbi aktet dhe shërbimet gjyqësore, garancitë etj, të cilat në total arrijnë në vlerën 30,141,365,27 (tridhjetëmilion e njëqind e dyzet e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë pike njezet e shtatë) Lekë të derdhura në Buxhetin e Shtetit. Tendencë kjo në rritje në krahasim me vitin 2023.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës rezulton të jetë mjaft efektive në vjeljen e të ardhurave që në momentin e dorëzimit të kërkesë-padive, kërkesave të tjera të taksës gjyqësore apo në shpenzimet e njoftimit.

Realizimi i të ardhurave për vitin 2024 paraqitet si më poshtë vijon:

Klasa	Artikulli	E M E R T I M I	Mujori progresiv
7	7081006	Taksa e Akteve dhe e Pulles (10% i te ardhura nga pullat)	598,220.00
7	7112100	Te ardhura nga tarifa gjyqësore (10% i te ardhurave nga 1%)	1,118,244.93
7	7109600	Te ardhura nga qerja	
7	7115600	Te ardhura nga sekuestrimi dhe zhdemtime	
7	7110199	Te tjera te ardhura sekondare(+posta)	13,000.00
7	7115401	Gjoha gjyqësore	50,000.00
7	7111008	Te ardhura nga fotokopja	278,330.00
7	7200105	Grant nga nje nivel qeverisje	
7	7190990	Te ardhura te tjera jo tatimore (KADASTRA)	
7	7113099	Te ardhura te tjera nga shitja e mallrave dhe shërbime	
7	7000900	Te tjera tatime mbi te ardhurat mbajtur ne burim	
7	1161190	Te Ardhura tjera, shitja aktiveve qendrushme	
		TOTALI	2,057,794.93

4	466	Garanci pasurore	12,635,400.00
4	466	Garanci punimesh	
4	4662100	Garanci bankare kavaja	
4	4662306	Garanci pasurore kavaja	
4	466	Garanci te tjera ne ruajtje	
4	466	Derdhje gabim	
		TOTALI	12,635,400.00
4	4665100	Depozitime te tjera ne ruajtje 90% I te ardhurave nga pullat	5,383,980.00
4	4665100	Depozitime te tjera ne ruajtje 1% kërkesë paditë	10,064,190.34
	4665100	Depozitime te tjera ne ruajtje sipas akt rakordimit te Kj	
		TOTALI	15,448,170.34
		TOTALI 2023	30,141,365.27

Ky Sektor për përmbushjen e detyrimeve financiare mbështet shumë në ligjet dhe ndryshimet e pësura në vitin 2024 ku mund të përmendim ndër vendimet më të rëndësishme gjatë vitit 2024 që kanë pasur karakter financiar dhe që kanë ndikuar në punën e Sektorit, si dhe vendimet me të rëndësishme ku mbështetet puna e këtij Sektori janë konkretisht si më poshtë:

Vendimi Nr.421, datë 26.06.2024 “ Për disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimin Nr.325,datë 31.05.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesa të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike,” të ndryshuar, Ndryshimit të tatimit mbi të ardhurat ne muaji Maj 2023 sipas legjislacionit në fuqi,

Vendimi Nr. 422, datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në Vendimin 326 date 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetes dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve te ndryshme në disa institucione në Administratës publike” të ndryshuar , kthim përgjigja e Ministrise se Financave për shtesat e vështirësise dhe dëmshmerisë në punë të punonjësve mbështetës.

Udhëzimi Nr. 559, datë 29.12.2022 “Për caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të gjyqtarit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë”, Vendim i Këshilli të Lartë Gjyqësor Nr. 661, datë 02.11.2023 “Për përllogaritjen e pagës referuese bazë të magjistratit (gjyqtar), për periudhën 1 janar 2019 deri më 08 janar 2023”, Ligjin nr. 96 /2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” neni 12, neni 14, neni 168 dhe neni 169, i ndryshuar, Vendimin nr. 34, datë 10.4.2017 (V-34/17), të Gjykatës Kushtetuese, Vendimi Nr. 38 datë 28.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për pagesën e Gjyqtarëve më ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare”, i ndryshuar me Vendimin Nr.674, datë 08.11.2023 “ Për një ndryshim në Udhëzimin Nr.38, datë 28.02.2019”, Vendimin nr.113, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale” , Udhëzimin nr.48, datë 08.02.2022 “ Për mënyrën dhe procedurën e kompensimit për orët shtesë të kryera mbi kohën normale të punës, nga nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjësit e tjerë të administratës gjyqësore”,

Mbështetur në të gjitha vendimet e mësipërme janë bërë pagesat për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore si dhe shpenzimet operative për mbarrëvajtjen e punës në gjykatë.

Si më poshtë janë paraqitur plani i buxhetit akorduar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe realizimi nga ana e gjykatës tonë për zbatimin e tij,

Art	EMERTIMI	Viti 2024	
		Plan (Nga fondet buxhetore)	Fakt (Nga fondet buxhetore)
600	Paga	148,000,000	135,679,660
601	<i>Kont. Sig.shoqerore</i>	20,650,000	16,012,874
602	<i>Mallra e sherbime tjera</i>	28,900,000	26,188,287
606	<i>Trans. Tek individ</i>	501,820	501,820
231	<i>Investime gjithesej</i>	852,000	673,227

Si paraqitet gjykata ka një realizim të mirë me efikasitet dhe efektivitet të buxhetit për vitin 2024. Në shpenzimet për paga realizimi i tij është 91.67 %, në shpenzimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore realizimi është 77.54%, në shpenzimet operative 90.61% dhe investimet në masën 79% të buxhetit të akorduar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në bashkëpunim me KLGJ aplikojnë sistem financiar elektronik KREATEX i cili është program bashkohor, që mundëson informacionin kontabël të nevojshëm dhe të domosdoshëm sipas të gjitha kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Gjatë vitit 2024 Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka bërë çdo muaj raportime on-line në KLGJ nëpërmjet sistemit finaciar KREATEX, në Degën e Thesarit Durrës raporton on-line nëpërmjet sistemit AFMIS, në Tatim Taksa Durrës nëpërmjet 2(dy) sistemeve on-line, e-fiskalizimi dhe Tatimet e mia dhe në Sigurimet Shoqërore Durrës nëpërmjet on-line e-albania, në zyrën e Statistive të Rrethit Durrës.

Kjo rritje e kërkesës në sisteme të ndryshme raportimi ka çuar në rrijen e punës së kësaj strukture.

Problematikë jo vetëm e gjykatës tonë mbetet mospasja e një mënyre matjeje të shpenzimeve gjyqësore sa i takon koston të gjykimit, apo koston së shqyrtimit së seancës gjyqësore, e cila aktualisht barazohet vetëm me shpenzimet për njoftimet e palëve.

Ndërkohë, në vendet e tjera një kosto e tillë përllogaritet me koston e punës së paguar të gjyqtarit dhe administratës gjyqësore, si dhe me matës të tjerë, të cilët janë të nevojshëm për analizën e koston më pas. Mbetet për t'u parë në të ardhmen përgatitja dhe vënia në funksionim nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor e një mënyre për përllogaritjen e kostove të mësipërme.

Nga kjo anë do të merren masa nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor që të saktësohet, formalizohet dhe unifikohet formati i llogaritjes së shpenzimeve gjyqësore dhe kodifikimi i tyre sipas gjyqtarëve dhe të mundësohet shtimi i një opsioni në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve

gjqësore, ku të evidentohet vlera e objektit të padisë, tarifa gjyqësore dhe pagesa e saj, në mënyrë që të sigurohet kontrolli i kësaj të ardhure.

Një problematikë tjetër që kemi hasur gjatë vitit 2023, i cili është zgjidhur gjatë vitit 2024 ka qënë pagesa e shërbimeve të parapaguara të kadastrës, pasi në kontrollin e fundit u la rekomandim që asnjë veprim me Kadastrën të mos parapaguhej nga ana e gjykatës.

Sipas VKM Nr.389, datë 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale” gjykata është e detyruar të paguajë faturat e fiskalizuara të kadastrës për shërbimet kadastrale të nevojshme në proceset gjyqësore deri par ardhjes së Auditit të Kljg-së.

VKM-ja në fjalë parashikon mënyrën e aplikimit dhe tarifat standarte për çdo shërbim të kadastrës, por nuk rregullon mënyrën e pagesës së kësaj tarife nga qytetari si kërkues i shërbimit.

Në këto kushte gjykata ka hasur mjaft vështirësi në mbledhjen e detyrimeve për këto shërbime nga qytetarët të cilët janë palë në procese gjyqësore të përpara ardhjes së Auditit nga Këshilli I Lartë Gjyqësor.

Tashmë kjo problematikë ka gjetur zgjidhje pasi gjyqtarët japin Autorizim për këto pagesa paleve të ineteresuara dhe ato paraqiten vetë përpara Kadastrës për marrjen e shëebimit të kërkuar nga ana e gjykatës dhe nga ana e gjyaktës nuk janë prauar më parapaqime të tilla për Kadastrën.

Problematikë tjetër që ka vazhduar dhe pergjatë vitit 2024 është mungesa e një udhëzimi për përcaktimin e tarifës dhe mënyrës së pagesës së tarifës së shpërblimit për psikologët kryesisht, gjatë procesëve penale me të mitur. Aktualisht psikologët paguhën sipas Udhëzimit të përbashkët Nr.8, datë 19.07.2022 “Për përcaktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar”.

Problematikë tjetër gjatë vitit 2024 është hasur edhe me pagesat e faturave të Insitutit të Mjekësisë Ligjore, të cilet në momentin e kërkesës nga gjyqtari i cështjës për Akt ekspertim mjeko ligjor sjellin bashkëlidhur me aktin dhe faturën për atë akt ekspertimi të kryer.

Kjo faturë depozitohet shumë vonë në Sektorin e Buxhetit përtej cdo afati, pasi pagesa e faturave bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e lëshimit të tyre.

Sipa mendimit tim, gjyqtari në momentin e marrjes së shkresës përcjellëse me informacionin në lidhje me aktin e ekspertimit nga Instituti i mjeksisë Ligjore të depozitojë në Sektorin e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar një Vendim të ndërmjetëm së bashku me kopjen e akit të ekspertimit dhe të faturës, ku kanë kërkuar pagesën e këtij shërbimi, si dhe vendimin për pagesën e tij në mënyrë që kjo proçedure të paguhet brenda afatit ligjor.

Zyra e Kryesekretarisë

Zyra e Kryesekretarisë është “zemra” e administrimit të një gjykate. Kjo zyre ka përgjegjësinë kryesore për shërbimet ndaj publikut. Kushdo që paraqitet në gjykatë për të marrë një shërbim, ndeshjen e parë e ka me punonjësit e administratës gjyqësore, të cilët janë personat e parë që orientojnë, qytetarët për të realizuar në kohë përmbushjen e të drejtës.

Roli dhe funksionimi i administratës gjyqësore nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm organizativ të pushtetit gjyqësor. Administrata gjyqësore është pjesë integrale e organizimit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës përgjatë vitit 2024 u gjend para një situatë të vështirë jo vetëm me baze materiale në mungesë, por dhe me burimeve njerezore në mungesë, vecanërisht pas adhjes në dënim të Marrëveshjes Nr. 4814/1 Prot., datë 26.09.2023, midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorisë së Përgjithshme, ku u parashikua se Seksioni Civil i Gjykatës do të transferohej pranë godinës të ish-Gjykatës së Apelit Durrës.

Struktura aktuale e gjykatës për 2024 ishte e papërshtatshme, çka do të thotë se ishte një administratë e cila e kishte të vështirë përmbushjen e misionit të saj në shërbim të qytetarëve.

Konkretisht, me transferimin e seksionit civil pranë godinës së ish Gjykatës së Apelit Durrës lindi si domosdoshmëri marrja e masave të nevojshme për një funksionim të mirë të administrimit të këtij seksioni në realizimin e shërbimeve

Për këtë arsye, Këshillit të Gjykatës përgjatë vitit 2024 pati një detyrë të rëndësishme mbi formulimin e një strategjie organizative, ku gjykata jone duhet të poziciononte veten me përdoruesit e saj duke marrë në konsideratë burimet aktuale që ajo kishte.

Për këtë arsye, me Vendimin e Këshillit Nr. 67 datë 20.09.2024, u morën masat organizative mbi akomodimin e Seksionit Civil, ku u transferuan dhe një pjesë e nepunësve gjyqësorë dhe e stafit, konkretisht 1 (një) Kryesekretare e Seksionit Civil, 9 (nente) nepunës në pozicionin e “sekretarit gjyqësor” dhe një pjesë e stafit.

Struktura organizative e administratës sonë gjyqësore përbëhet në total prej 23 gjyqtarësh dhe 22 sekretarësh gjyqësorë. Në Zyrën e Kryesekretarisë, nga numri total i miratuar prej 22 punonjës në këtë sektor ka mungesë të numrit të pozicionit të “sekretarëve gjyqësorë” në raport me numrin prej 23 gjyqtarësh të miratuar.

Kjo strukturë e miratuar nga KLGJ-ja, duhet parë si diçka dinamike, e cila ka nevojë të ndryshohet përgjatë vitit 2025 dhe të përshtatet në varësi të nevojave për përsosjen e veprimtarisë së administratës gjyqësore.

Për vetë rëndësinë e pozicionit të “sekretarit gjyqësor”, i cili është një pozicion i rëndësishëm që lidhet me funksionimin normal të punës në Gjykatë, rritja e numrit të pozicionit të “sekretarit gjyqësor”, në organikë do të ndihmojë për vitin 2025 në përballimin normal të punës. Duke parë trendin gjithnjë e më rritje të ngarkesës, jo vetëm që numri i sekretarëve gjyqësorë duhet të jetë i njëjtë me atë të gjyqtarëve, por është e domosdoshme rritja e numrit të sekretarëve gjyqësorë, duke parë edhe rritjen e ngarkesës të punëve administrative.

Nevojën për shtesë organike në pozicionet e “sekretarit gjyqësor” në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, përgjatë vitit 2024 e kemi vlerësuar të rëndësishme si pasojë e gjendjes faktike dhe rrethanave/arsyeve. Rritja e numrit të sekretareve gjyqësore do të ndikonte drejtpërdrejt në lehtësimin e punës, përballimin e ngarkesës, në respektim të afateve ligjore të shqyrtimit dhe arsyetimit apo dorëzimit të vendimeve.

Edhe përgjatë vitit 2024, Këshilli i Gjykatës ka vijuar të mbajë orarin e shërbimit në sportel nga ora 08:00 –16:00 për veprime të ndryshme me qytetarët dhe avokatët, duke vendosur njoftime me sqarime të nevojshme lidhur me çështje të caktuara, si dhe duke rritur në mënyrë të vazhdueshme efikasitetin dhe etikën e personelit të gjykatës në komunikimin me qytetarët. I është kushtuar rëndësi aksesit të të interesuarve në dokumentacionin dhe aktet e gjendura në Gjykatë. Nderkohe ka vijuar praktika e pagesës për administratën gjyqësore për orët e gadishmerisë, për të cilat kanë dalë në punë në ditët e pushimit, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Gjykatës Nr. 225, datë 01.06.2022, “Për mënyrën e pagimit të daljes në punë dhe pagesat jashtë kohës normale të punë për administratën gjyqësore të gjykatës”, të VKM-së Nr. 732, datë 13.11.2019 “Për rregullat për kohëzgjatjen e punës, orët jashtë orarit dhe shpërblimin e tyre si dhe kompensimin e shpenzimeve për kryerjen e detyrës jashtë vendit të punës për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe të prokurorisë” dhe Udhëzimit Nr. 48, datë 08.02.2022 “Për mënyrën dhe procedurën e kompensimit, për orët shtesë të kryera mbi kohën normale të punës, nga nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjësit e tjerë administrativë në gjykatë”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve

Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve synon të pasqyrojë, në mënyrë të përmbledhur, analizën e veprimtarisë administrative të zhvilluar nga kjo strukturë përbërëse pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për vitin kalendarik 2024.

Sipas strukturës dhe organikës për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është 77 (shtatëdhjetë e shtatë) punonjës në plan.

Në fillim të vitit 2024, për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për sa i përket numrit “faktit” të gjyqtarëve, efektivisht kanë ushtruar këtë funksion 11 (njëmbëdhjetë) prej tyre. Kështu, Gjyqtare Nurjeta Pogaçe (Tafa) me Vendimin Nr.94, datë 20.02.2024, të Këshilli të Lartë Gjyqësor është komanduar në pozicionin “Pedagoge e Brendshme” pranë Shkollës së Magjistraturës, ndërkohë me vendimin Nr. 155, datë 27.03.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur komandimin e gjyqtarës Anjeza Buzo në pozicionin Këshilltar ligjor, në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Si rezultat i skemës së transferimit, numri i gjyqtarëve është rritur në mënyrë graduale. Për gjyqtarët e transferuar nga procedurat e mëparshme, konkretisht z.Olti Skrame, z.Shkëlzen dhe Znj.Suela Xhani, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Transferimin e Gjyqtarit Olti Skrame në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

Durrës, dhe për Gjyqtarët Shkëlzen Liçaj dhe Suela Xhani është vendosur “Përsëritjen e transferimit të përkohshëm”.

Më pas, Këshilli i Lartë Gjyqësor mori vendimet Nr. 471, 472, 473, 474, 475 dhe 476, datë 31.07.2024, duke transferuar me pëlqim në këtë gjykatë, gjyqtaret Alban Veçani, Arbër Çela, Xhevdet Lika, Ervin Sulaj, Rudi Laze dhe Marjola Beluli, nga data 11.09.2024 e në vijim, organika u plotësuar organikën me 16 (gjashtëmbëdhjetë) gjyqtar. Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin Nr.658, datë 31.10.2024, ka konkluduar për pranimin e kërkesës. Miratimin e qëndrimit në detyrë të magjistratit Z. Rexhep Bekteshi, deri në moshën 70 vjeç...”

Për sa i përket numrit të punonjësve sipas strukture për administratën gjyqësore, aktualisht ushtrojnë funksionin 51 (pesëdhjetë e një) punonjës, nga 54 që janë të parashikuar. Më hollësisht, të ndarë në struktura e shërbime gjyqësore;

1 Kancelar

2 Kryesekretar (Dhoma Civile/Penale),

22 sekretar gjyqësor

4 Shefë Sektori, specialistë, dhe punonjës të tjerë me funksione të strukturave të shërbimeve administrative dhe mbështetëse, të ndara në: (1 specialist buxheti, 1 specialist/finance, 1 specialist IT, 1 specialiste për marrëdhëniet me publikun, 2 specialist protokollit, 1 specialiste arkive, 3 Nëpunës Civil /Zyra e Shërbimit, Sektori Kordinimit të Zyrave dhe Shërbimit dhe Protokoll/Arkivë dhe 14 punonjës të tjerë mbështetës.

Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshme Durrës mbështetur në pikën 17 të Vendimit nr.71, datë 20.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës” në fillim të vitit miraton kalendarin për mbledhjet mujore, por që krahas tyre mbledhjet zhvillohen edhe jashtë këtij kalendari të miratuar, për shkak të vendimmarrjeve të ndryshme.

Gjatë periudhës të vitit 2024, Këshilli i Gjykatës ka operuar me procedurat e rekrutimeve duke u mbështetur në ligjin Nr. 98/2019, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), Vendimit Nr. 622 datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit Nr. 85 datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimin nëpërmjet konkurimit të hapur”, si dhe Vendimit Nr.338, datë 24.09.2020 për “Përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”, të detajuar si mëposhtë:

Për procedurën e rekrutimeve, gjithsej janë shpallur 9 (nëntë) vende vakante, për pozicionet si vijon:

“Për pozicionin Sekretar Gjyqësor” janë shpallë 6 (gjashtë) vende vakante, të emëruar 6 (gjashtë) në këtë pozicion, të cilët janë (Xh.Rrasa, I.Lipe, M.Bejko (l.p.), E.Kurbiba, N.Katellari, E.Picari.

Për procedurën “Listë pritje, pozicion sekretar gjyqësor për vitin 2024”, qëndrojnë dy kandidatë: N.Llukaj dhe V.Hoxha.

Punësuar me kontratë zëvendësues gjithsej 1(një), për shkak të nëpunësit civil gjyqësor aktualisht me leje lindje.

Për pozicionin “Specialist/Arkivë”, shpallur 1 (një) vend vakantë, dhe emëruar në këtë pozicion 1 (një) nëpunës, D.Gjiza.

Për pozicionin “Specialist/Statistik”, shpallur 1 (një) vend vakantë, emëruar me lëvizje paralele në këtë pozicion 1 (një) nëpunës, B.Dizdari

Për pozicionin “Specialist/Buxheti”, shpallur 1 (një) vend vakantë, dhe emëruar në këtë pozicion 1 (një) nëpunës, G.Minxha.

Kërkesat për dorëheqje, total 7 (shtatë)

Këshilli i Gjykatës është shprehur me vendim për 6 (gjashtë) nëpunës civil gjyqësor, (I.Bajrami, F.Hushi, L.Sofka, I.Beqiraj,B.Dizdari dhe G.Gjojdeshi) sipas arsyes së motivimit (2 dorëheqje për shkak të lëvizjes paralele, larguar në një gjykatë tjetër), (3 dorëheqje për arsye personale), (1 dorëheqje për shkak të ndryshimit të pozicionit) dhe 1 dorëheqje, miratuar me Urdhër të Kancelares së Gjykatës, për shkak të rregullimit ligjor me Kod Pune.

“Konfirmim të dhënies së Statusit të nëpunësit civil gjyqësor”, total 3 (tre), në respektim të vendimit Nr.338, datë 24.09.2020 për “Përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”, referuar dhe ndryshimit të ligjit Nr. 98/2019, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, për nëpunësit:

*N.Rustani (pozicion Specialist/Financë)
Arba Asllanaj (pozicion sekretar gjyqësor)
Sara Bllaca (pozicion sekretar gjyqësore)*

Nëpunësit të cilët kanë mbushur moshën për pension pleqërie, total 2(dy)

*M.Kaba (Shef Sektori, Sektor Protokoll/Arkivë,)
B.Kasa (Nëpunës Civil, në Zyrën e Shërbimit, në Sektorin e Koordinimit të Zyrave të Shërbimit dhe Protokoll/Arkivë)*

*Vende vakante për vitin 2024 të paplotësuar janë 2(dy);
1 Specialist/Buxheti
1 Shofer*

Sot, kjo gjykatë ka mungesë të burimeve njerëzore, e cila afekton në mënyrë të drejtpërdrejtë në veprimtarinë gjyqësore. Veçanërisht, Sektori i Burimeve Njerëzore mbulohet nga një nëpunës civil gjyqësor që është “Shef Sektori”, i cili kryen detyrat e specialistit të burimeve dhe specialistit prokurimeve. Për sa i takon këtij të fundit, është një tregues që ka të bëjë me sigurimin e ecursisë të procedurave të prokurimit, shërbimeve dhe mallrave në gjykatë.

Për të realizuar në mënyrën më korrekte dhe efikase detyrat është e nevojshme kompletimi i këtij sektori nga dy specialist, mbështetur në VKM-në, Nr.893, datë 17.02.2014 *“Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, pika 2, dhe 22, përcakton se “Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e veçantë kur në të janë të paktën një pozicion shef/përgjegjës sektori dhe dy vartës. Një sektor mund të krijohet edhe pa pozicionin e shefit/përgjegjësit, nëse është në kuadër të një drejtorie dhe ka të paktën dy nëpunës.*

Në kuadër të VKM-së cituar mësipër Këshilli i Gjykatës, vendosi suprimimin e vendit vakant në pozicionin *“Nëpunës gjyqësor”*, pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe hapjen e pozicionit *“Specialist Buxheti”* pranë Sektorit të Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Shtimi i organikës për gjykatën tonë, janë padyshim nevoja imediate që duhen realizuar me qëllim garantimin e rritjes së efikasitetit në punë, duke përmendur si vijon:

Mbetet e nevojshme që çdo gjyqtar të asistohet nga dy sekretar gjyqësor, për shkak të fluksit të regjistrimit të çështjeve çdo ditë, zhvillimi i seancave gjyqësore, përfundimi i procedurës së mbylljes së dosjes fizikisht dhe elektronikisht, njoftimet, planifikime, si dhe mekanizma të tjera që kërkojnë përkushtim, përgjegjësi dhe përgjegjshmëri.

Me marrjen në posedim të godinës së ish Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe me kalimin e Dhomës Civile pranë kësaj godine është e domosdoshme shtesë organike për Specialist IT. Aktualisht, dy gjykatat mbulohen vetëm nga 1 Specialist IT, që përveç ngarkesë, janë dhe dy godina larg njëra-tjetrës. Pa anashkaluar pjesën tjetër që kërkohet suport për anën elektronike në mbështetje të stafit të gjykatës, gjë e cila kërkon përfshirjen e specialistit. Po kështu, pa llogaritur atë ç’ka është më e rëndësishme mirëmbajtja e sistemit ICMIS.

Pozicion specialist buxheti, ka mbetur sërish vend vakant, për shkak të dorëheqjes nga detyra të nëpunësit të emëruar.

Nga ana e Zëvendëskryetarit të Gjykatës është shprehur angazhim maksima në përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore dhe nënligjore në kuadër të veprimtarisë së kësaj gjykate për përmirësimin e burimeve njerëzore, e cila sjellë rritje në cilësinë dhe performancën e shërbimeve të ofruara për përdoruesit e gjykatës.

Lidhur me procedurat e prokurimit gjëj me vend të përmendet rikonstruksioni i ish godinës së Gjykatës së Apelit Durrës, si rezultat i marrëveshjes së dakordësuar midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokuroria e Përgjithshme, të cilët kanë nënshkruar *“Mbi funksionimin e godinave nga gjykatat dhe prokuroritë e rretheve gjyqësore në zbatim të hartës së re gjyqësore”*. Për shkak të kushteve jo të mira infrastrukturore të ish godinës së Gjykatës Apelit Durrës, falë bashkëpunimit me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në muajin Korrik 2024, ka bërë kërkesë për fonde, me qëllim që të ndërmarren një sërë hapash të nevojshëm për funksionalizimin e godinës brenda standardeve

dhe garancive të parashikuara për akomodimin pranë kësaj godine. Nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor është bërë përcjella e fondit për realizimin e parashikimeve sipas preventivit. Me ardhjen e këtij fondi për rikonstruksionin e godinës së ish Gjykatës së Apelit Durrës si dhe me shtimin në organike të 6 (gjashtë) gjyqtarëve me datë 31.07.2024 është vlerësuar me përparësi marrja e masave për kalimin e seksionit civil në godinën e ish kësaj gjykate. Në fillim të muajit Gusht 2024, është zhvilluar procedura e prokurimit me objekt “*Rikonstruksioni godinës së ish-Gjykatës së Apelit Durrës*”, punime të cilat mbaruan me sukses në fillim të muajit Shtator 2024.

Gjatë gjithë periudhës vjetore është mbajtur nën kontroll sistemi elektrik, i është kushtuar rëndësi mirëmbajtjes së ambienti rrethues, zona përreth godinës, njëkohësisht së fundi është riparuar sistemi izolimit në dhomën civile për të shmangur çdo lloj problematike që mund të shfaqet për hyrjen e shiut.

Sektori i Protokollit, Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit

Organika e Sektorit të Protokollit, Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për vitin 2024 përbëhet nga 7 (shtatë) punonjës, 1 (një) Shefe Sektori, 3 (tre) specialiste protokoll/ Arkivë dhe 3 (tre) nëpunës civil gjyqësor pranë Zyres së Shërbimit në ish Godinën e Gjykatës Rrethit Kavajë.

Për sa i përket godinës aktuale ekzistuese të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, si një problematikë e adresuar ndër vite, “ambientet arkivore” për vendosjen e dokumentacionit arkivor janë të papërshtatshme. Të gjitha zyrat e përshtatura për Arkivë janë pothuajse të tejmbushur me dosje gjyqësore të viteve shumë të hershme.

Për shkak të ambienteve të pamjaftueshme për vendosjen e dosjeve gjyqësore, arkiva penale dhe civile është e shpërndarë në shumë ambiente të ndryshme të gjykatës dhe një pjesë e tyre madje janë vendosur në garazhet e gjykatës të cilat janë të tejmbushur me dosje.

Me kalimin në përgjegjësi të ish-godinës së Gjykatës së Apelit Durrës në favor të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, u mendua që një pjesë e fondit arkivor të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës të transferohej pranë Dhomes Civile në ish godinën e Gjykatës Apelit Durrës duke i përshtatur zyrat e atit të katërt të kësaj godine si ambiente arkivore me dollape metalike.

Pavaresisht kushteve të ambjenteve, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka marrë masa lidhur me plotësimin e kushteve të sigurisë për vend-ruajtjet e dokumentacionit arkivor. Të gjitha vendet e ruajtjes së këtyre dokumentave janë të pajisura me fikëse zjarri, matës temperature dhe lagështire, izolim me hekura të dritareve, si dhe raftet ku janë vendosur dokumentacioni i arkivuar janë metalike. Ajrimi i ambjenteve arkivore bëhet në mënyrë natyrale nga dritaret, gjithashtu secili ambient arkivor është i pajisur me kondicioner.

Në ambientet e Arkivave janë vendosur fikse zjarri të cilat janë pajisur edhe me Çertifikatën përkatëse nga MZSH Bashkia Durrës që i plotësojmë kushtet e mbrojtjes nga zjarri.

Është vijuar lidhja e dosjeve me spango dhe jo futja e tyre nëpër kuti (sipas udhëzimeve të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor Lundër) me qëllim krijimin e sa më shumë hapsirave të lira.

Rëndësi e madhe për vitin 2024 i është kushtuar manaxhimit të këtij sektori arkivor. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ka marrë masa lidhur me zbatimin e kërkesave të Ligjit Nr. 9154, datë 05.11.2003 “Për arkivat”.

Nga ana e specialisteve të Arkivës janë merre masa që dokumentacioni administrativ i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të përpunohet sipas kërkesave të Ligjit Nr. 9154, datë 05.11.2003 “Për arkivat” dhe normave tekniko – profesionale e metodologjike të Shërbimit Arkivor të Republikës së Shqipërisë.

Në reference të Rregullores “Për asgjësimin e dokumentacionit arkivor në gjykata” ka filluar puna për asgjësimin e dokumentacionit arkivor nga grupi i punës së ngritur me Urdherin Nr 5 Prot date 04.02.2024 të Zv Kryetari të Gjykatës. Pas përgatitjes së listave, ky grup ka dërguar pranë ASHSGH (Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor) materialet e praktikës së përpunimit të dokumenteve arkivore gjyqësore civile e penale sipas Formulareve mod.1 të përpunimit si dhe Formularet mod.3 të listave të vecimit, me qëllimin e marrjes nga ky institucion konfirmimi mbi rregullsinë e tyre sipas rregullores e Vendimit 426 të KLGJ.

Me ardhjen e konfirmimit nga ASHSGH me Vendimin Nr 4 date 25.09.2024 të Komisionit Epror të Ekspertizës të Sistemit Gjyqësor si dhe në zbatim të Urdherit Nr 240 date 05.11.2024 Zv Kryetari të Gjykatës u bë asgjësimi i dosjeve me djegje duke u mbajtur dhe proces-verbalet përkatëse .

Konkretisht gjatë vitit 2024 u asgjësuan për Zyren e Arkivës në Durrës gjithsej 2084 dosje , nga këto 1572 penale dhe 512 civile. Nr total i fletëve 30.514 flete.

Dhe për Zyren e Arkivës të ish Gjykatës Kavaje u asgjësuan gjithsej 4419 dosje , nga këto 857 penale dhe 3562 civile. Nr total i fletëve 100.167 flete

Dhe për gjatë vitit 2024 vazhdoi kontrata nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me subjektin “PC STORE” me objekt “Program digjitalizimi i arkivave të gjykatave”, ku puna u mbyll në fund të dhjetorit të 2024.

Për gjatë vitit 2024 janë skanuar 77.335 (shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e pesë) vendime gjyqësore.

Nga fillimi i programit të digjitalizimit deri më 31 Dhjetor 2024, në gjykatën tonë janë skanuar:

- Vendimet gjyqësore civile që i përkasin viteve 1976 deri në vitin 2021,
- Vendimet gjyqësore penale që i përkasin viteve 1976 deri në vitin 2020,

- Vendimet gjyqësore penale ushtarake që i përkasin viteve 1975 deri në vitin 1992,
- Regjistrat themeltar civil dhe penal që i përkasin vitit 2016.

Nga fillimi i programit të digjitalizimit deri më 31 Dhjetor 2024, në gjykatën tonë kanë mbetur për t'u skanuar:

- Vendimet gjyqësore civile që i përkasin viteve 1946 deri në vitin 1975, dhe vendimet gjyqësore civile të viteve 2022, 2023, 2024,
- Vendimet gjyqësore penale që i përkasin viteve 1946 deri në vitin 1975, dhe vendimet gjyqësore penale të viteve 2021, 2022, 2023, 2024,
- Vendimet gjyqësore penale ushtarake që i përkasin viteve 1968 deri në vitin 1974,
- Regjistrat themeltar civil dhe penal (përveç vitit 2016 që është skanuar),
- Numratorët e vendimeve,
- Dokumentat administrative etj.

Ndërkohë për vitin 2024 nga ana e specilaisteve të Arkivës u janë dhënë shërbime qytetareve dhe institucioneve si kopje të dokumenteve gjyqësore, kopje vendimi (arkiva), kopje të dosjeve gjyqësore etj

Nga ana e FAE (Formulari i Aplikimit Elektronik) u është dhënë shërbimi për 1202 (një mijë e pesëdhjetë e pesë) kërkesave të bëra. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ndër vite ka qenë pararojë në ofrimin e këtij shërbimi, i cili ju vjen në ndihmë qytetarëve.

Ndërkohe pjesë e këtij sektori është dhe Zyra e Shërbimit Kavajë ku dhe përgjatë vitit 2024 vazhduan punën 3 (tre) nëpunës civil, nga keta 1 (një) arkivist dhe 2 (dy) specialiste.

Dhe gjatë vitit 2024 prioritet në punë e përdishme të kësaj zyre ishte transparenca dhe aksesimi mbi marrjen e shërbimit në kohë të përdoruesve të gjykatës tonë

Në këtë Zyrë Shërbimi është mbajtur orari i shërbimit në sportel nga ora 08:00 –16:00 për veprime të ndryshme me qytetarët dhe avokatët, duke vendosur njoftime me sqarime të nevojshme lidhur me çështje të caktuara, si dhe duke rritur në mënyrë të vazhdueshme efikasitetin dhe etikën e personelit të gjykatës në komunikimin me qytetarët.

Përgjatë vitit 2024, në këtë zyrë shërbimi janë kthyer nga Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm të Apelit Tiranë 84 (tetëdhjetë e katër) dosje gjyqësore dhe nga Gjykata e Lartë 88 (tetëdhjetë e tetë) dosje gjyqësore

Zyra e Shërbimit Kavajë, për vitin 2023 ka trajtuar rreth 462 kërkesa lidhur me institucione të ndryshme dhe subjekte fizikë.

Nëpunësit pranë kësaj zyre, janë në komunikim të vazhdueshëm me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, kryesisht elektronik (nëpërmjet e-mail zyrtarë) me qëllim shmangien e zvarritjeve në kohë që vijnë nga distanca fizike Durrës-Kavajë dhe me qëllimin e ofrimit të një shërbimi cilësor e të shpejtë në kohë

Shërbimet që ofrohen nga kjo zyrë janë të njëjta sikundër shërbimet që ofrohen nga Gjykata si dhe në portal është pasqyruar edhe vendndodhja fizike e Zyrës së Shërbimit Kavajë.

- **Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe regjistrimi AUDIO i seancave gjyqësore**

I. VOLUMI I ÇËSHTJEVE

Gjatë vitit 2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës janë paraqitur gjithsej për gjykim 7791 çështje nga të cilat: 3401 (44%) çështje themeli penale e civile; 4390 (%) kërkesa administrative penale e civile nga të cilat: 981 kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, 950 kërkesa gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe 1743 kërkesa në Seancë Paraprake (Grafiku nr.1).

Numri i seancave të zhvilluara dhe regjistruara sipas të dhënave të Sistemit Elektronik PAKS+ për vitin 2024 për shqyrtimin e çështjeve në total është 23570, për vitin 2023 është 24997 seanca, ndërsa numri i seancave për vitin 2022 është 18210.

Numri i seancave audio 9818, e shprehur në përqindje numri i seancave audio për periudhën 1 Janar 2024 deri me 31 Dhjetor 2024, ka qenë 41.7%, ndërsa diferenca është mbajtur në zyrat e gjyqtarëve për shkak të mungesës së sallave të gjykim dhe volumit të madh të seancave që zhvillohet në një ditë.

Sipas Komisionit European për Eficencën në Drejtësi (CEPEJ) për të analizuar të dhënat statistikore në tërësi përdoren 2 indikatorë që janë Clearance Rate (CR indicator) i cili tregon raportin midis çështjeve të regjistruara me çështjet e përfunduara në përqindje dhe Disposition Time (DT) i cili tregon raportin e shpejtësisë së përfundimit të çështjeve gjyqësore të ardhura në gjykatë në ditë.

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës rezulton se Clearance Rate për çështjet Penale (Treguesi Normale përfundimit/Likuidimin e çështjeve) gjatë vitit 2024 është 100 % dhe Clearance Rate për çështjet Civile është 103 %.

Koha e nevojshme për përfundimin e një çështje penale për vitin 2024 është 135 ditë dhe për çështjet civile është 294 ditë.

Clearance rate penal (Treguesi Norma e Përfundimit/Likuidimit të Çështjeve)

$$CR_{penale}2024 = \frac{\text{numri i çështjeve të përfunduara}}{\text{numri i çështjeve të reja}} * 100 = \frac{4140}{4109} * 100 = 100 \%$$

Clearance rate Civil (Treguesi Norma e Përfundimit/Likuidimit të Çështjeve)

$$CR_{civile}2024 = \frac{\text{numri i çështjeve të përfunduara}}{\text{numri i çështjeve të reja}} * 100 = \frac{3823}{3682} * 100 = 103 \%$$

Case disposition time penale (Koha e nevojshme për Përfundimin/Likuidimin e Çështjeve)


$$DT_{penale}2024 = \frac{\text{numri i çështjeve në pritje për gjykim më 31.12.2023}}{\text{numri i çështjeve të zgjidhura}} * 365 = \frac{1528}{4140} * 365 = 135$$

Case disposition time civile (Koha e nevojshme për Përfundimin/Likuidimin e Çështjeve)

$$DT_{civile}2024 = \frac{\text{numri i çështjeve në pritje për gjykim më 31.12.2023}}{\text{numri i çështjeve të zgjidhura}} * 365 = \frac{3075}{3823} * 365 = 294$$

Grafiku nr. 1


Grafiku i ngarkesës për gjykatën në tërësi



Konstatohet se në numrin total të çështjeve për gjykim në vitin 2024 ka ulje të numrit të çështjeve të ardhura nga viti 2023, nga 8608 çështje gjatë vitit 2023 në 7791 gjatë vitit 2024.

Grafiku nr. 2

Numri i çështjeve për gjykim themeli



Sa i përket çështjeve civile themeli vërehet ulje e lehtë e numrit nga 2201 në vitin 2023 në 2199 në vitin 2024 dhe për çështje penale vihet re rritje e numrit nga 1060 në vitin 2023 në 1202 në vitin 2024 (Grafiku nr.3).

Pavarësisht se numri i çështjeve ardhura të reja për vitin 2024 ka qënë në ulje në krahasim me vitin 2023 nuk do të thotë që ngarkesa e gjyqtarëve ka qënë më e ulët për vitin 2024 pasi numri i çështjeve të mbartura të cilat presin për gjykim nga viti 2023 është 4603 duke e bërë në këtë mënyrë numrin e çështjeve për gjykim në 12394. (Tabela Nr.1 dhe Nr.2)

Nëse do ti referohemi çështjeve të gjykuara (të përfunduara) numri total i çështjeve të shqyrtuara gjatë vitit 2023 ka qënë në total 8043. Nga këto numri i çështjeve të përfunduara civile ishte 3633 dhe i atyre penale 4410. Për sa i përket vitit 2024 numri total i çështjeve të përfunduara është 7963, nga këto numri i çështjeve civile është 3823 dhe numri i çështjeve penale 4140. Nga krahasimi i këtyre dy viteve rezulton një rritje e çështjeve të gjykuara civile, ndërkohë që për çështjet penale të përfunduara penale kemi ulje.

Ndërkohë, 865 çështje civile janë mbyllur me vendim jopërfundimtar nga ana e gjykatës në raste të tilla si: kur është vendosur pushimi i çështjes për shkak të zgjidhjes së saj jashtëgjyqësisht, pushimit të çështjes për shkak të heqjes dorë nga gjykimi i padisë, pushimit për shkak të mosparaqitjes së paditësit apo ankuesit, vendime pezullimi, pushim për shkak të tërheqjes së të dëmtuarit akuzues në rastin e veprave penale që gjykohen mbi ankimin e këtij të fundit, shpalljes së moskompetencës tokësore apo lëndore, etj.

Lidhur me llojin e natyrës së çështjeve, nga të dhënat statistikore rezulton se në kategorinë e çështjeve civile gjatë vitit 2024 janë gjykuar 703 çështje civile të përgjithshme me palë kundërshtare, 1385 çështje familjare me palë kundërshtare, 727 çështje me objekt “Zgjidhje Martese”, si dhe 78 çështje “Marrëdhënie pune”.

Për vitin 2024 është vënë re një rritje e numrit të çështjeve të përfunduara me objekt “Marrëdhënie pune”. Ndërkohë vazhdon të jetë i lartë numri i çështjeve me objekt “Zgjidhje martese”. Ndërsa për sa i përket, padive me objekt “kundërshtim i veprimeve përmbarimore” për vitin 2024 janë shqyrtuar në total 47 çështje.

Për sa i përket numrit të kërkesave të seancave paraprake si kërkesa penale për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesa për pushimin e çështjes penale për krime apo ankim ndaj vendimit të pushimit të çështjes për kundërvajtje penale vihet re një rritje për vitin 2024. Kështu në vitin 2023 ishin paraqitur për gjykim gjithsej 1670 kërkesa të seancës paraprake, ndërkohë për vitin 2024 janë paraqitur 1743. Nga këto ka përfunduar gjykimi në vitin 2023 për 1622 çështje dhe për vitin 2024 ka përfunduar gjykimi për 1121 çështje. (Tabela nr.3/a)

Për çështjet penale themeli numri më i madh i tyre i takon veprës penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal me 180 të dënuar, vepra penale për Nenin 134 të K.Penal me 142 të dënuar, për Nenin 291 të K.Penal me 332 të dënuar. (Tabela Nr. 4)

Për vitin 2024, mbi bazën e vendimit datë 27.03.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur komandimi i gjyqtarës Anjeza Buzo në pozicionin e këshilltares ligjore.

Për vitin 2024, mbi bazën e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur emërimi i gjyqtarës Diamela Goxha në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit më datë 26.07.2024 vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Znj.Shpëtime Pitaku gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Në vitin 2024 Këshilli i Gjykatës ka marrë vendimin për ndarjen e seksionit penal dhe civil të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në dy godina të ndryshme.

Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Jurisiksionit të Përgjithshëm Durrës, funksionon Seksioni për të Mitur, i cili përbëhet nga gjyqtarët Paulin Çera, Besjana Garxenaj dhe Sokol Mara, të specializuar në këtë fushë, që gjykojnë njëkohësisht edhe çështjet për të rritur.


Gjatë vitit 2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Jurisiksionit të Përgjithshëm Durrës janë regjistruar 9 çështje penale ku të pandehur kanë qenë persona të mitur dhe kanë përfunduar gjatë këtij viti 17 çështje. Në caktimin e masave të dënimit është aplikuar Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe në rastet e tjera janë aplikuar dënimet alternative sipas Kodit Penal. (Tabela Nr.3/b)

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit të aplikuar nga gjykata në çështjet penale të gjykuara gjatë vitit 2024, referuar të dhënave të Tabelës Nr.5 konstatohet se lloji më i përhapur i dënimit është ai me burgim deri në 2 vjet (387 raste), ndjekur nga dënimi 2-5 vjet burgim (53 raste) dhe ai me me gjobë (18 raste).

Ndërkohë, gjatë vitit 2024 dënimet alternative rezultojnë të jenë aplikuar nga gjykata në 606 raste, ndër të cilat 544 është aplikuar neni 59 i Kodit Penal (pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim), në 62 raste gjykata ka vendosur punë me interes publik (neni 63 i Kodit Penal). (Tabela nr. 5)

Lidhur me disponimet e gjykatës për “Masat e sigurimit personal” janë të paraqitura grafikisht si më poshtë:

Grafiku nr.3 i masave të sigurimit




Nga 950 kërkesa gjatë fazës së hetimeve paraprake të paraqitura për vitin 2024, masa sigurimi të dhëna nga gjykata janë respektivisht: 388 raste arrest në burg, 36 raste arrest në shtëpi, 312 raste detyrim paraqitje, 9 raste arrest në mungesë, 4 raste mjekim i detyruar dhe 6 raste garanci pasurore.

Sa i përket gjykimeve të tjera të posaçme pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Jurisiksionit të Përgjithshëm Durrës gjatë vitit 2024 janë paraqitur për gjykim 113 kërkesa me gjykim të drejtpërdrejtë.

Gjatë vitit 2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Jurisiksionit të Përgjithshëm Durrës kanë ushtruar efektivisht detyrën, duke marrë pjesë edhe në short, gjithsej 12 gjyqtarë, të cilët në periudha të caktuara mund të kenë qenë të përjashtuar nga shorti për shkak të mungesës në punë për arsye shëndetësore.


Gjatë vitit 2024 janë shqyrtuar nga Zëvendëskryetari i Gjykatës 126 “Kërkesa për heqje dorë” nga të cilat 93 kërkesa janë miratuar dhe 33 kërkesa janë refuzuar. (Grafiku 3/a | Tabela 3/c).

Grafiku nr. 3/a
Kërkesa për heqje dorë ndër vite



Kërkesat për përjashtimin e gjyqtarit janë paraqitur gjithsej 31, nga të cilat 18 kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit në proces penal dhe 13 kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit në proces civil. (Grafiku Nr.3/b)

Grafiku Nr. 3/b



II. SHPEJTËSIA NË GJYKIM

Përsa i përket shpejtësisë në gjykim, Gjkata e Shkallës së Parë të Jurisiksionit të Përgjithshëm Durrës paraqet tregues të kënaqshëm në funksion të dhënies së drejtësisë, brenda një afati të arsyeshëm kohor sipas detyrimeve procedural dhe parashikimeve kushtetuese të nenit 42/2 dhe nenit 6§1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Një pengesë në shpejtësinë e gjykimit edhe në vitin 2024 e bën sistemi i shërbimit postar të njoftimeve, shtrirja e gjerë territoriale në të cilën ushtron veprimtarinë Gjkata dhe mungesa e një sistemi të saktë adresash.


Faktorët e jashtëm që kanë ndikuar në shpejtësinë në gjykim janë kërkesat e palëve për t’u mbrojtur me avokat pa e siguruar një mbrojtje të tillë para se të fillojë procesi gjyqësor dhe për të paraqitur prova, paraqitja e kërkesave për shtyrje të seancës, nisur nga pjesëmarrja në gjykim tjetër etj.

Ndër faktorët e tjerë të brendshëm që ndikojnë në shpejtësinë e gjykimit është ngarkesa shumë e lartë në punë për secilin gjyqtar, referuar numrit mesatar të çështjeve për gjyqtar dhe organikës së gjykatës.

Lidhur me shpejtësinë në gjykim, kanë përfunduar deri në 6 muaj (3814) 92 % e çështjeve penale, kanë përfunduar brenda periudhës 6 muaj - 1 vit (293) 7 % e çështjeve dhe 1% e çështjeve ka përfunduar mbi 1 vit.(33) (shih Grafikon Nr.4/ Tabela Nr.6).

Grafiku Nr. 4


Grafiku bazuar në numrin e seancave: Penale



Ndërkaq, kanë përfunduar për periudhën deri në 6 muaj (2399) 63% e çështjeve civile, kanë përfunduar brenda periudhës 6 muaj - 1 vit (1022) 27% e çështjeve, ndërkohë që në periudhat mbi 1 vit kanë përfunduar (402) vetëm 10% e tyre (Shiko grafikun Nr. 5/tabela 6).


Grafiku Nr. 5

Grafiku bazuar në kohëzgjatjen e seancave: Civile



Grafiku nr. 6

Grafiku bazuar në kohëzgjatjen e seancave: Civile dhe Penale



Ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në shpejtësinë e gjyimit padiskutim më i rëndësishmi mbetet sistemi i adresave, i cili i lidhur me ndryshimet procedurale ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjyimit.

Megjithatë, në shpejtësinë e gjyimit ndikojnë edhe faktorë të tjerë, menaxhimi i çështjes për gjykim nga ana e vetë gjyqtarit, lloji i gjyimit (gjykim i shkurtuar ose i drejtpërdrejtë në çështjet penale dhe ai i kërkesave civile), kompleksiteti i çështjes, realizimi i njoftimeve të rregullta të palëve e dëshmitarëve, përgjigjia e institucioneve publike e private, etj., faktorë ndër të cilët vend të veçantë zë edhe sjellja e palëve ndërgjyqëse gjatë gjyimit, çka rezulton ende të jetë shkak kryesor për shtyrjen e seancave gjyqësore.

PROGRAMI I TRANSPARENCËS

Parimi i transparencës dhe aksesit në Gjykatë është një ndër pikat kyçe të cilës së fundmi i është kushtuar një rëndësi e veçantë. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në kuadër të përshtatjes edhe të situatës së krijuar (tërmet, pandemi, ngarkesë e madhe çështjesh, riorganizim i hartës gjyqësore etj.) me qëllim aksesin në gjykatë, shmangien e vonësive, marrjen e shërbimeve nga përdoruesit/qytetarët, vijimin e veprimtarisë administrativo-gjyqësore, ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushtet për aksesimin në shumë mënyra si on-line edhe fizikisht të një sërë shërbimesh në gjykatë të cilat i ofrohen përdoruesve.

Ligji Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (i ndryshuar), në nenin 91 të tij, parashikon qasjen në drejtësi aksesin, transparencën dhe marrëdhëniet me publikun. Gjithashtu, sikurse për çdo autoritet tjetër publik, ligji për të drejtën e informimit i ngarkon Gjykatat me detyrime specifike për të ndërtuar dhe garantuar transparencë mbi veprimtarinë e tyre për palët në proces, grupet e interesit, publikun dhe median.

Sa më sipër, kryesisht nëpërmjet faqes zyrtare

<https://gjykata.gov.al/rrethi-durr%C3%ABs/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-durr%C3%ABs/> të Gjykatës përdoruesit mund të ndjekin ecurinë e gjykimeve në porces shqyrtimi në të cilat janë palë ndërgjyqësre, mund të aksesojnë një sërë të dhënash statistikore për qëllime studimore, informacion me ineteres public, për zbatimin e parimit të transparencës etj., mund të shohin në kohë reale shortin elektronik, fazën e gjykimit të çështjes për të cilën janë të interesuar, mund të shikojnë datën e seancës së ardhshme, vendimet përfundimtare etj.

Gjithashtu është zgjeruar mënyra e kërkimit të informacionin në Gjykatë si për kërkimet e informacionit po ashtu edhe dokumentacionit apo akteve të tjera.

Aktualisht përdoruesit për marrjen e informacionit dhe dokumentacionit nga Gjykata mund të aplikojnë dirket në **“Formularin për marrjen e dokumentacionit nga Gjykata”** i cili gjendet në faqen zyrtare të gjykatës si dhe mund të bëjnë kërkesë në postën elektronike të gjykatës zmp.gjykatarrrethidurres@gjykata.gov.al. Këtë shërbim mund ta marrin edhe fizikisht pranë Sportelit të Shërbimit të Gjykatës. Gjithashtu në çdo rast mund të zgjedhin të përdorin aksesin në mënyrë tradicionale nëpërmjet kërkesave të ardhura nga shërbimi postar. Pra, përdoruesit e Gjykatës kanë në dispozicion shumëllojshmëri mënyrash jo vetëm si të aksesojnë Gjykatën por edhe të marrin shërbim.

Në kuadër të përmirësimit të shërbimit, ky shërbim elektronik paraqitet si shumë i dobishëm pasi u vjen në ndihmë qytetarëve/përdoruesve të gjykatës që të dërgojnë një aplikim, për t’u pajisur me kopje të dokumenteve gjyqësore të tilla si, kopje vendimi viti aktual, kopje vendimi (arkiva), kopje të dosjeve gjyqësore, vërtetim për çështje në proces gjykimi (individ), vërtetim për çështje në proces gjykimi (shoqëri tregtare), vërtetim për ndjekje penale.

Formulari online i aplikimit, është shtuar tashmë si rubrikë e re, në profilin e çdo Gjykate, në portalin www.gjykata.gov.al por sjellim në vëmendje se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës tashmë e ka të konsoliduar këtë mjet të ri aksesit pasi e ka bërë pjesë të saj vite me parë.

Të dhënat e grumbulluara nga aplikimet, përpunohen dhe ruhen në përputhje të plotë me parashikimet e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. (Gjejmë rastin të shprehim se gjatë viti 2024 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka patur rol interaktiv duke dhënë mendim në konsultimet publike të deritanishme për ndryshimet që kërkohen të bëhen në Ligjin “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”).)

Për të nisur procesin e aplikimit për një nga dokumentet e sipërcituara, kërkuesi, plotëson të gjitha informacionet e kërkuara brenda këtij formulari on-line, konkretisht <https://gjykata.gov.al/rrethi-durr%C3%ABs/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-durr%C3%ABs/formular-aplikimi/>

Pas dërgimit të aplikimit drejt Gjykatës, ai procesohet nga nëpunësi i Gjykatës, dhe në varësi të informacionit, kthimi i përgjigjes dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet duke u paraqitur pranë ambienteve të Gjykatës (përfshirë edhe kryerjen e pagesës sipas tarifave të përcaktuara) ose kur është rasti ato përcillen elektronikisht pa qenë nevoja e paraqitjes fizikisht në Gjykatë.

Referuar sa më sipër, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është në bashkëpunim të vazhdueshëm me Këshillin e Lartë Gjyqësor me qëllim impementimin sa më të saktë lidhur me komunikimin elektronik, me qëllim trajtimin e këtyre kërkesa që do të vijnë nga ky shërbim i ri.

Programi i transparencës tashmë mund të themi që është standardizuar (kryesisht për të gjitha institucionet), konsoliduar dhe shërben më së miri si udhërrëfyes për të gjithë veprimtarinë e institucionit, duke nisur që te informacionet më bazike deri tek ato më të dobishme për vijimin e gjykimit. Po kështu në këtë program përveç informacioneve gjenden edhe shërbimet që ofrohen nga Gjykata, mënyra e përdorimit të tyre deri tek marrja e shërbimit të kërkuar. Vetë programi i transparencës, përtej detyrimit ligjor për zbatimin e tij, është shumë i dobishëm pasi shmang një sërë veprimesh që më parë kryheshin vetëm fizikisht, lehtëson së tepërmi marrjen e shërbimeve nga përdoruesit e Gjykatës si dhe paraqitet tepër efikas veçanërisht në aspektin kohor. Ky program aksesohet lehtësisht nga Portali i Gjykatës, konkretisht në linkun: <https://gjykata.gov.al/rrethi-durr%C3%ABs/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-durr%C3%ABs/programi-i-transparencës/programi-i-transparenc%C3%ABs/>

Në përputhje me nenin 7 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” në faqen zyrtare është publikuar programi i transparencës për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Nëpërmjet këtij programi përcaktohet korniza ligjore e veprimtarisë së autoritetit në kuadër të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (edhe në kuadër të Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, (të ndryshuar).

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nëpërmjet pasqyrimit të tij në faqen zyrtare <http://www.gjykata.gov.al> si dhe në mjediset e pritjes së publikut (holli i Gjykatës).

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është një institucion që ka marrë të gjitha masat për respektimin maksimal të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj, duke publikuar/përditësuar në faqen e saj elektronike zyrtare të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji si të detyrueshëm për publikim.

Dokumentacioni i bërë publik, është i përditësuar në formë dhe përmbajtje. Faqja zyrtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun/përdoruesit e Gjykatës, pa kërkesë, në format lehtësisht të kuptueshëm, ku në bashkëpunim me Specialistin e IT-së përditësohet nga data e krijimit të saj referuar kërkesave të përdoruesve të bazuara në Ligjin Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Koordinatori për të drejtën e informimit:

Bazuara në parashikimet e Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara prej tij, Gjykata jonë vijon të ketë Koordinatorin për të Drejtën e Informimit (i emëruar më Vendim të Këshillit të Gjykatës) i cili zbaton detyrat sipas Nenit 10 të këtij Ligji.

Edhe gjatë vitit 2024 është konsoliduar implementimi e Hartës së Re Gjyqësore, bashkimit faktit dhe juridik të Gjykatave (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë), vetë Gjykata dhe veçanërisht Koordinatori për të Drejtën e Informimit (në bashkëpunim dhe me udhëzimet e KLGJ) ka ndërmarrë një sërë veprimesh me karakter informues dhe ndërgjegjësues për të gjithë përdoruesit e Gjykatës, për funksionimin tashmë si një Gjykatë e vetme nën emrin Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Ndërkaq, ndarja e Gjykatës në dy seksione, Seksioni Civil dhe Seksioni Penal në dy godina të ndryshme, është një nga risitë e vitit 2024 që përveçse ishte një nevojë dhe përmirësim për veprimtarinë gjyqësore, solli sfida të konsiderueshme për t’u përballuar si nga vetë administrata po ashtu edhe nga të gjithë përdoruesit e Gjykatës.

Informimi mbi funksionimin e Seksionit Civil dhe Penal të Gjykatës, në dy godina të ndryshme, të pavarura fizikisht, është kryer në shumë forma, me qëllim informimin sa më të gjerë të përdoruesve të Gjykatës.

Konkretisht janë shpërndarë Fletëpalosje me të gjitha informacionet bazike mbi funksionimin e Sesionëve të Gjykatës, transferimin e çështjeve apo procedurën e tyre që nga depozitimi deri në përfundim të gjyqimit.

Janë kryer sesione informuese së bashku me shpërndarjen e Fletëpalosjeve/Broshurave tek target grupet/audienca e synuar të cilat kanë impakt të gjerë informimi siç janë studentët e Fakultetit të Drejtësisë.

Po kështu këto Fletëpalosje i janë përcjellë edhe grupeve të interesit siç janë Mediat, me qëllim zgjerimin dhe përhapjen me shpejtësi të informacioneve të dobishme për përdoruesit e Gjykatave.

Gjithashtu këto fletëpalosje janë shpërndarë edhe në rrjetet sociale të Gjykatës, po ashtu janë pasqyruar edhe në faqen zyrtare të Portalit të Gjykatës.

Në çdo rast, këto informacione Fletëpalosje/Broshura etj., aksesohen edhe fizikisht, të afishuara pranë ambienteve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës po ashtu edhe Zyrës së Shërbimit Kavajë.

Në këtë kuadër, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ka shfrytëzuar çdo aktivitet të saj apo të përbashkët me të tretët për të përcjellë të gjithë informacionin e nevojshëm mbi implementimin e hartës së re gjyqësore dhe funksionimin tashmë si një Gjykatë e vetme.

Gjatë vitit 2024 janë trajtuar rreth 120 kërkesa në përputhje me Ligjin Nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit” (i ndryshuar)*. Në asnjë rast nuk është ushtruar ankim tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Gjatë vitit 2024 vihet re një rritje e konsiderueshme e numrit të kërkesave për informacion si dhe konstatohet se këto kërkesa vijnë në Gjykatë nga mënyra dhe nga subjekte/grupe të ndryshme interesi si psh: me kërkesë me shkrim fizikisht (apo nëpërmjet shërbimit postar), nëpërmjet e-mail zyrtar apo aplikimeve on-line në portal.

Sjellim në vëmendje se për vitin 2024, duke mbajtur në konsideratë ndarjen e Seksionit Civil dhe Seksionit Penal, si edhe konsolidimin e vijimit të bashkimit të bashkimit të dy Gjykatave, një pjesë e konsiderueshme e kërkesave që u paraqiten për trajtim kanë qenë edhe nga Zyra e Shërbimit Kavajë ose kërkesa që kanë lidhje me vijim/procedurën që do të ndiqet për kërkesat apo çështjet që janë transferuar nga ish-Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Po kështu, në vitin 2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka vijuar me kryerjen e veprimeve konkretet (të përcjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor materialet mbi Njoftimin e Vendimit Nr. 454, datë 02.11.2022 *“Për miratimin e planit të komunikimit për gjykatat”*) sipas *“Planin e Veprimit”*.

Sikundër dihet, ende vijon të jetë i zbatueshëm Planin i Komunikimit 2-vjeçar (pasi zbatimi i tij është më periudhë të përcaktuar, pra 2022-2024) ku ky plan synon të strukturojë të gjithë aktorët institucionalë, mediat, shoqërinë, qytetarët, përdoruesit e gjykatës, të kenë lehtësisht akses në sistemin gjyqësor dhe të përfitojnë shërbimet në mënyra novative. Ky plan është në përputhje të Planin Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, shoqërohet me Plan Veprimi, duke përcaktuar idetë dhe mjetet praktike për lehtësim të aksesit në sistemin gjyqësor, mjetet e komunikimit, objektivat, grupet e interesit, institucionet përgjegjëse zbatuese, burimet e financimit, indikatorët e vlerësimit etj. Qëllimi kryesor është rritja e transparencës, niveli i informimit, cilësia e shërbimeve, diversifikimi i mjeteve të komunikimit, aksesimi sa më i lehtë i sistemit gjyqësor në tërësi.

Vendimi Nr. 454, datë 02.11.2022, i KLGJ-së, *“Për miratimin e Planit të Komunikimit për Gjykatat”*, kërkon nga Këshillat e Gjykatave, për të caktuar një pike kontakti që do të raportojë çdo tre muaj pranë Drejtorisë për Marrëdhënies me Median dhe Publikun në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për zbatimin e Planit të Komunikimit.

Referuar parashikimeve ligjore të Ligjit Nr. 119/2014, Koordinatorin për të drejtën e informimit është njëkohësisht edhe Personi i Kontaktit për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka caktuar si person kontakti për raportimin në KLGJ për monitorimin dhe zbatimin e Planit të Komunikimit për Gjykatën, Specialistin për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median.

Pika e kontaktit paraqet çdo 3 muaj, raportin e realizimit dhe ecurisë së zbatimit të Planit, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas formatit të unifikuar të raportit, shtojcë e këtij Planit. Monitorimi do të mbështetet në progresin e zbatimit të çdo aktiviteti të parashikuar në Planin e Veprimit duke ndjekur rregullisht zbatimin e aktiviteteve sipas përshkrimit, afatit e realizimit të tyre dhe përmbushjen e indikatorëve të parashikuar. Qëllimi i këtij monitorimi është adaptimi/përmirësimi i planit në varësi të kushteve, rrethanave apo nevojave që gjykatave mund t'i lindin gjatë kohës së zbatimit të tij. Gjykatat në raportin e monitorimit të realizimit të Planit do të paraqesin edhe vështirësitë dhe rekomandimet për përmirësim apo rishikim.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, aktualisht është në zbatim të plotë të hapave konkretë konform parashikimeve të Udhëzuesit të Planit të Veprimit.

Specialisti i Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë

Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës vijon të jetë në strukturën e saj edhe Specialisti për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median.

Ky pozicion është riemëruar dhe mbeti i pandryshuar edhe në Strukturën e Re pas Implementimit të Hartës së Re Gjyqësore, ku detyrat e ZMP u përshkruan në Vendimin Nr. 150, datë 29.03.2024 *“Për Miratimin e Rregullave Standarde për Organigramën, Përshkrimin e Detyrave dhe Përgjegjësi të Pozicioneve të Nëpunësve Civilë Gjyqësorë dhe Punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kategoria e Dytë dhe e Tretë, me Zyra Shërbimi”*, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një Risi për Vitin 2024, është edhe konkludimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor me Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 *“Për miratimin e udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”*

Udhëzuesi standard për marrëdhëniet e gjykatës me publikun e median përcakton rregullat dhe procedurat e informimit dhe komunikimit me publikun dhe median, me ose pa interesimin e tyre të drejtpërdrejtë, me qëllim përcjelljen e informacionit mbi veprimtarinë e gjykatës në mënyrë të drejtë, uniforme, të barabartë, të shpejtë dhe efikase. Udhëzuesi synon rritjen e transparencës, besimit të publikut dhe të kuptueshmërisë nga publiku dhe media të veprimtarisë gjyqësore, nëpërmjet standardizimit të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median.

Bashkëlidhur këtij Vendimi janë miratuar në format tip edhe:

1. Deklaratë pëlqimi për përpunimin e të dhënave personale;
2. Deklaratë konfidencialiteti;

3. Formular për përfaqësuesit e medias kërkesë për regjistrimin/transmetimin e imazheve filmike të seancës gjyqësore

Të gjitha këto formate tip, janë detyrimore për zbatim si nga Gjykata po ashtu edhe nga Media, të cilat janë tepër të dobishme pasi standardizojnë mënyrën dhe procedurën për trajtimin e kërkesave dhe veçanërisht pjesëmarrjes në gjykim të medias. I gjithë vendimi koornizon në mënyrë të drejtpërdrejtë marrëdhënien e Gjykatës me Median ku secili nga aktoret gjen lehtësi në bashkëveprim dhe shmang çdo situatë evazive apo abuzim të mundshëm me të dhënat persoanle.

Vendimi Nr. 716, datë 06.12.2024, përveçse është pasqyruar në portalin e Gjykatës dhe rrjetet sociale, i është përcjellë është target grupit i cili ka interes të shtuar siç janë përfaqësues të medias. Po kështu, vlen të theksohet se Vendimi i sipërcituar është zbatuar në të gjitha rastet pas miratimit të tij (plotësimi i kërkesave apo deklaratave tip varësisht sipas rastit).

MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA DHE PUBLIKUN

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, natyrshëm përveç veprimtarisë gjyqësore në fokus ka edhe bashkëpunimin si me institucionet e tjera, po ashtu edhe me grupet e tjera të interesit, organizatat e ndryshme (OJF/OJQ/qendra etj.), median, publikun si dhe çdo përdorues tjetër të Gjykatës.

Disa nga bashkëpunimet ndërinstitutionale më të shpeshta të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës gjatë vitit 2024 janë:

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor (Gjykata, ka patur bashkëpunim të ngushtë me KLGJ si një organ qeverisës, si në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi por edhe për implementimin e risive të reja siç është Formulari i Aplikimit Elektronik apo inicimi për të jetësuar parashikimet në Planin e Komunikimit dhe Planit të Veprimit për vitin 2022-2024);
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Komisionin e Pavarur të Apelimit etj., (Gjykata gjatë viti 2023 ka trajtuar një numër të madh shkresash ardhur nga institucionet e vetëqeveritjes, si dhe ka treguar angazhim dhe saktësi maksimale, nisur nga rëndësia e veçantë e këtij procesi pavarësisht se ky i fundit është drejt përfundimit të qëllimit për çfarë u krijua);
3. Bashkia Durrës (vazhdimisht Gjykata ka bashkëpunim me Bashkinë Durrës dhe vlerëson rolin saj proaktiv sidomos angazhimit të njësive respektive pranë Bashkisë që trajtojnë çështjet e dhunës në familje apo çështjet me të miturit në konflikt me ligjin) Së fundmi Gjykata i është përgjigjur pozitivisht dhe me gatishmëri kërkesës së Bashkisë për bashkëpunim Nr. 4967 Prot., datë 01.06.2022, për ngritjen e “*Këshilli Vendor për Siguri Publike*”, në të cilën Bashkia Durrës do të vijojë me procedurat e ngritjes së “*Këshillit Vendor për Siguri Publike*”, këshill në të cilin bën pjesë edhe Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës).

4. Bashkia Shijak (njësoj si me Bashkinë Durrës)

5. Gjykatat e tjera apo Prokuroritë;

Si një ndër institucionet kryesore me të cilat gjendet në marrëdhënie të vazhdueshme pune, marrëdhëniet me Prokurorinë pranë kësaj gjykate kanë qenë në fokus të vazhdueshëm në funksion të përmirësimit të proceseve të punës dhe zgjidhjes së problematikave të hasura. Sjellja e prokurorëve reflektohet përgjithësisht korrekte. Vlen të theksohet se përgjithësisht problematikat e ngritura respektivisht nga të dy institucionet kanë gjetur përgjigje. Veçanërisht rëndësi gjate vitit 2024 i është kushtuar dorëzimit të vendimeve brenda afatit ligjor, komunikimit të tyre palëve dhe dërgimit të dosjeve në gjykatën e apelit

6. Institucionet e tjera publike (Gjykata ka trajtuar çdo kërkesë nga institucionet publike sipas parashikimeve ligjore në fuqi dhe me prioritet)

7. Dhoma e Avokatisë Durrës (bashkëpunim në përcjelljen e Listës së Avokatëve Kryesisht, në mënyrë periodike si dhe korrektesë në sjelljen e përgjithshme të avokatëve. Po kështu marrë shkas nga bojkotimi i senacave gjyqesore nga avokatat- si një problematikë e mbartur ndër vite mbi ambientet e përshtatshme dhe të veçanta për shërbimin ndaj avokatëve-Gjykata disponoi nëpërmjet Urdhrit Nr. 130 Prot., datë 03.06.2024 “*Për marrjen e masave për respektimin dhe solemnitetin e gjykit*”. Ky urdhër normon veprimtarinë gjyqesore si dhe është i detyrueshëm për të gjithë përdoruesit e gjykatës.

Urdhrin e gjeni të publikuar në portalin e Gjykatës, konkretisht në linkun <https://gjykata.gov.al/rrethi-durr%C3%ABs/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-durr%C3%ABs/njoftime-p%C3%ABr-median/>;

8. OJF/OJQ dhe organizata të tjera të shoqërisë civile- (Gjykata ka trajtuar me seriozitet çdo kërkesë për informacio/dokumentacion etj., të ardhur prej tyre);

9. Qendra e Ndihmës Juridike Falas Durrës (Me mbështetjen e UNDP, Gjykata e Shkallës Së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas kanë nënshkruar “*Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës*” që prej dhjetorit të vitit 2020 e në vijim, e cila konsiston në përdorimin e ambienteve të vendosura në dispozicion pa kundërshtpërblim pranë Gjykatës për t’u përdorur si “*Qendër e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore*”. Gjykata ka treguar bashkëpunim si në zbatim të marrëveshjes, në ofrimin e komoditetit të kushteve të punës QNJF si dhe në përcjelljen dhe trajtimin e shkresave voluminoze/statistikore nga qendra. Vlen të përmendim se problematikat e qytetarëve që kanë kërkuar ndihmë pranë kësaj qendre, kanë qenë nga më të ndryshmet, pjesa më e madhe në fushën civile, dhe në raste të pakta kanë qenë çështjet penale, kjo edhe për shkak të faktit se në çështjet penale është e parashikuar edhe mbrojtja

e detyrueshme nga shteti për çështje të caktuara. Shumica e qytetarëve/subjekteve kanë të kategorisë si individ pa të ardhura, ndjekur më pas nga personat me aftësi të kufizuar dhe viktimat e dhunës në familje.

9. Studentët e Drejtësisë (Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ofron mbështetje, inkurajim dhe të gjitha kushtet e përshtatshme për ndjekjen e seancave gjyqësore veçanërisht nga studentët e drejtësisë);
10. Media (Gjykata gjatë vitit 2024 ka bashkëpunuar ngushtësisht me Median e shkruar dhe vizive. Kjo reflektohet edhe nga numri i madh i kërkesave për informacion dhe dokumentacion nga Media. Kjo rritje e shumëfishuar për informacion vjen si pasojë e lehtësirave dhe diversifikimit të mënyrave të aksesit të informacioneve/dokumentacioneve në Gjykatë po ashtu edhe për shkak të intensifikimit të fundit të ngjarjeve që përbëjnë interes publik);
11. Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale (si në bashkëpunim për orientime të ndryshme po ashtu edhe në takime konsultative);
12. Partnerët ndërkombëtare;
13. Shkolla e Magjistraturës (ofrimi i ndihmës/informacioneve etj., kryesisht studentëve të shkollës);
14. Përdoruesit e tjerë të Gjykatës etj.

Disa Veprimtari të Rëndësishme të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës gjatë vitit 2024

1. FAE (Formulari i Aplikimit Elektronik) (KLGJ në 17.01.2021 përcolli pranë Gjykatës për shumëfishim Kartë me Kod QR për Formularin e Aplikimit Elektronik si dhe detajet mbi përdorimin/implementimin e tij. Sikundër u shpreh edhe më lart duke qenë se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka qenë pararojë në ofrimin e këtij shërbimi, si dhe në kuadër të monitorimit të ofritit të shërbimit on-line në portalin e Gjykatës, gjykata.gov.al, lidhur me Formularin Elektronik të Aplikimit, KLGJ-së i janë përcjellë të dhënat statistikore mbi këtë shërbim);
2. Kodi i Anonimizimit si risi dhe implementim i ri i kësaj rubrike në portalin e Gjykatës:

(Në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, për mbarëvatjen e veprimtarisë administrativo-gjyqësore, referuar mbrojtjes së të dhënave personale, për të patur akses në portalin e Gjykatës, përdoruesit e saj, me qëllim ndjekjen e zhvillimit të seancave gjyqësore, iu nevojitet pajisja me Kodin e Anonimizimit. Gjykata në 24.05.2022 i ka përcjellë të gjithë nëpunësve kompetentë Manualin për Kodin e Anonimizimit për njohje dhe zbatim. Është vënë re se ky implelementim ka funksionuar si dhe shërben si mbrojtës për të dhënat e përdoruesve të gjykatës. Kodi i Çështjes së bashku me Kodin e

Anonimizimit (kod unik për secilën çështje që gjenerohet automatikisht nga sistemi ICMIS), për çështje gjyqësore në shqyrtim, ky Kod jepet nga sekretarja gjyqësore palëve ndërgjyqëse, përfaqësuesve ligjore, përfaqësuesve me prokurë apo subjekteve të tjerë që legjitomohen për të marrë Kodin e Anonimizimit sipas legjislacionit në fuqi. Për çështjet e përfunduara (me status mbyllur) kodet respektive të çështjeve gjyqësore jepet palëve ndërgjyqëse apo përfaqësuesve nga Zyra e Kryesekretarisë apo nëpërmjet postës elektronike në çdo rast me kërkesë paraprake të tyre.)

3. Bashkia Durrës- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

(bashkëpunim i vazhdueshëm si për çështjet e dhunës në familje (kryesisht kjo fushë është përfaqësuar nga Kancelarja e Gjykatës. Ky bashkëpunim ndërmjet dy institucioneve ka pasur qëllim realizimin dhe mbikqyrjen e masave alternative të shmagies nga ndjekja penale nga dënimi për të miturit në konflikt me ligjin. Qëllimi i këtij bashkëpunimi për këtë kategori të miturve, ka qenë me qëllimin e trajtimit të tyre në qendra sociale që bashkia administron. po ashtu edhe angazhimit për pjesëmarrje të ZV/Kryetarit për ngritjen e “*Këshilli Vendor për Siguri Publike*”, në Bashkinë Durrës dhe Shijak);

4. Trajnimet/Takimet konsultative/ndërvepruese në fushën e të drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (këto trajnime janë ndjekur kryesisht nga Specialistja e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median si nëpunës kompetent i fushës). Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka marrë pjesë në Takimin Konsultativ me Kontrollues të Sektorit Publik për tema që kanë lidhje me të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

5. Në zbatim të Planit të Komunikimit për Gjykatat për 2022-2024 dhe Plani i Veprimit 2022-2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka miratuar këto të fundit si ka vijuar me krijimin e kushteve për implementimin e risive që sjellin këto dy akte, duke ndërmarrë hapa konkretë për të jetësuar Planin e Veprimit në Gjykatë. Ky plan vijon të zbatohet nëpërmjet hapave konkretë.

6. Komunikim me Median dhe Publikun- Gjykata gjatë vitit 2024 ka pasur komunikim të vazhdueshëm me median, ka intensifikuar marrëdhëniet mes tyre dhe duke u kujdesuar që informacioni i kërkuar prej tyre të jetë sa më i shpejtë në kohë.

DISA AKTIVITETET TË RËNDËSISHME-për gjatë vitit 2024
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DURRËS

1. **INTERSHIP – dhe Praktikant e Studentëve të Drejtësisë-gjatë gjithë viti 2024;**

2. **15 JANAR 2024- AKTIVITET I PËRBASHKËT (3-palësh) Gjykatw-Prokurori**

Shkolla e Magjistraturës.

Më datë 15 Janar 2024, për të diskutuar më gjatë mbi hartimin e një kurrikule trajnuese të plotë dhe të shtrirë në kohë, Shkolla e Magjistraturës realizoi një takim tre palësh ku nga analizat e diskutimet e shumta përgjatë këtyre viteve Shkolla ka arritur të identifikojë mënyra të mundshme për rritjen e efikasitetit të trajnimit vazhdues, forcimin e bashkëpunimit me gjykatat dhe prokuroritë e vendit dhe vendosjen në qendër të rolit dhe kontributit të magjistratit.

3. JANAR 2024 - MBLEDHJE NDËRINSTITUCIONALE BASHKIA Durrës- GJYKATA DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË QYTETIT TË DURRËSIT

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në Janar 2024, në kuadër të “Marrëveshjes së Bashkëpunimit Ndërinstitucional” për ngritjen e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si anëtare e Ekipit Ndërdisciplinor (ETN), mori pjesë në mbledhjen e përbashkët që u zhvillua për menaxhimin në praktikë të rasteve në praktikë me synimin e përmirësimit të trajtimit të çështjeve në vijim.

4. 17 JANAR 2024 / 18 JANAR 2024-TRAJNIM DHE AKTIVITET I PËRBASHKËT “KRIMI I ORGANIZUAR DHE REGJISTRIMI I KORRUPSIONIT (OCCTR)”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në datat 17/18 Janar 2024, mori pjesë në trajnimin dhe aktivitetin 2 ditor me temë: “Krimi i Organizuar dhe Regjistrimi i Korrupsionit (OCCTR)” ku, në këtë aktivitet, në kuadër të politikës së zgjerimit, vendeve kandidatë dhe kandidatëve potencialë u kërkohet t'i ofrojnë Komisionit statistika për korrupsionin, krimin e organizuar dhe krimet e rënda.

5. 9 SHKURT 2024- WORKSHOP I PËRBASHKËT- KËSHILLAT E GJYKATAVE- KLGJ-CEPEJ

Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Këshillin e Europës, në datën 09.02.2024, zhvilloi një workshop me antarët e Këshillave të Gjykatave ku u adresuan gjetjet që lidhen kryesisht me mbështetjen që administrata mund të ofrojë për rritjen e efikasitetit, shpejtesisë së gjykimit dhe reduktimit të backlog-ut, praktika të mira europiane dhe praktikën e Gjykatave tona.

6. 22 SHKURT 2024- WORKSHOP I PËRBASHKËT

**“SFIDAT E SHËRBITIT PSIKOLOGJIK NË SHQIPËRI PAS NGRITJES SË
URDHRIT TË PSIKOLOGUT”**

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në 22 Shkurt 2024 mori pjesë në Workshop e mbajtur në kuadër të aktiviteteve që Urdhri i Psikologut organizon lidhur me Semestrin e European Federation of Psychologists Associations. ku trajtoi sfidën e institucionalizimit të shërbimit psikologjik në institucionet e lidhura me sistemin e drejtësisë duke përfshirë edhe tema të lidhura me politikën ndërsektoriale, aksesin dhe qëndrueshmërinë e sistemit për shërbim psikologjik në kohë.

7. 7 Mars 2024- Takim i përbashkët-online-Akresi në Drejtësi

Kancelarët e Gjykatave, Ekspertë të lartë ligjorë, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë etj, më datë 07.03.2024, zhvilluan një takim të përbashkët on-line, me temë “Akresi në drejtësi”, ku takimi pasqyroj gjendjen aktuale në sistemin gjyqësor, Gjithashtu u adresuan gjetjet që kanë ardhur si pasojë e Reformës në Drejtësi dhe kontretisht Hartës së Re Gjyqësore (Sfidat dhe Problematikat).

8. 7 Mars 2024- Takim i përbashkët-Gjykata- EU4 Justice- projekt i Bashkimit Evropian-KLGJ-KLP-ILD- “Zbatimi i Hartës së Re Gjyqësore”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, mirëpriti dhe organizoi takimin e përbashkët në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore. Në vijimësinë e aktiviteteve të projektit EU4Justice në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor morën pjesë edhe ekipi i ekspertëve të EU4Justice, Z. Arturo Valdés, Gjyqtar i lartë spanjoll, Ekspert ndërkombëtar i projektit që mbështet KLGJ-në; Z. Rémy Le Donge L'Hénoret ekspert afatshkurtër, Gjyqtar francez; dhe z. Arben Lila, ekspert i lartë ligjor në projektin EU4Justice. Objektivi kryesor i takimit ishte përfitimi i një panoramë mbi dinamikat lokale, infrastrukturën, sfidat dhe mundësitë që dalin nga zbatimi i hartës së re gjyqësore.

9. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, përfaqësuar nga Zv/Kryetari Paulin Çera nga data 19.04.2024-29.04.2024 mori pjesë në vizitën studimore, organizuar nga Universiteti i Floridës së Jugut, në Shën Petersburg, të zhvilluar në Tampa - Florida dhe Washington DC, USA.

Në këtë vizitë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës u përfaqësua nga Zv/Kryetari Z. Paulin Çera si dhe morën pjesë Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor Z. Ilir Rusi, Z. Bezart Kaçkini, Zëvendëskryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe Z. Enkel Peza, Zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Kjo vizitë pati për qëllim kryesor marrjen dhe shkëmbimin e eksperiencës ndërinstitucionale veçanërisht lidhur fuqizimin e parimit të llogaridhënies dhe transparencës. Gjatë këtij aktiviteti u vizituan Qendra e Drejtësisë të Kontesë Pinellas, në Clearwater si edhe Gjykatën e Qarkut Tampa – Florida ku zhvilluan takime me gjyqtarë, dhe funksionarë të tjerë të lartë me të cilët u diskutua mbi sistemin gjyqësor amerikan dhe atë shqiptar. Takimet u shoqëruan dhe me pjesëmarrje në procese gjyqësore. Pjesëmarrësit morën pjesë në trajnime të cilat u finalizuan edhe me Çertifikata Pjesëmarrje.

10. DITA E DREJTËSISË 10 Maj 2024- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në 10 Maj 2024 përfaqësuar nga Zv/Kryetari Z. Paulin Çera, mori pjesë në mbledhjen e përbashkët vjetore të organizuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Ky

aktivitet i përbashkët u mbështet nga prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Projekti EU4Justice. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm z. Bajram Begaj, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Silvio Gonzato, Ambasadori i Bashkimit Evropian, z. David Wisner, i Ngarkuari me Punë i Ambasadës Amerikane, z. Ulsi Manja, Ministri i Drejtësisë, znj. Clarisse Pasztory Kryetare në Detyrë e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, anëtarët e të dy këshillave, përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet kushtetuese të Republikës, përfaqësues të trupës gjyqësore dhe të prokurorisë, si dhe partnerë ndërkombëtar. I gjithë aktiviteti në tërësi, rezultoi frytdhënës në shkëmbimin e kontributeve për zgjidhjen e situatave, përcolli impakt të lartë në publik dhe frymë bashkëpunimi për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

11. "ANALIZA VJETORE - 2023"

Z. Paulin Çera, në cilësinë e Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me datën 13.05.2024 prezantoi përpara trupës gjyqësore të kësaj Gjykate si dhe të ftuarve që morën pjesë "Analizën vjetore të punës për vitin 2023". Përveç trupës gjyqësore të Gjykatës në prezantimin e analizës së punës gjatë morën pjesë Zv/Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor Z. Ilir Rusi, Z. Markelian Koça si gjyqtar pranë kësaj Gjykate dhe njëkohësisht si antar i KLGJ, Drejtuesja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës Znj. Anita Jella dhe Kryetari i Dhomës së Avokatisë Durrës Z. Lorval Petani.

12. Aktivitet i përbashkët trajnues- datë 29-30 Maj 2024

Trajnim për marrëdhënien Medias me Gjyqësorin (Magjistratët e Medias: Gjyqtarët)- "Të jesh mediatikisht gati" Media dhe Gjyqësori Gjykata mori pjesë në aktivitetin e përbashkët trajnues me temë "Trajnim për marrëdhënien e Medias me Gjyqësorin", ku u përfaqësua nga Gjyqtarja e Medias Znj. Besjana Garxenaj.

Trajnimi ishte në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Magjistraturës për të asistuar në zhvillimin e kapaciteteve për Lirinë e Shprehjes të gjyqësorit.

13. Aktivitet i përbashkët trajnues- datë 6-8 Qershor 2024-

"Roli i Këshillit të Gjykatës në rritjen e treguesve të performancës. Ekipi drejtues kolegjal. Bashkëpunimi Kryetar, nënkryetar dhe kancelar" Gjykata mori pjesë në aktivitetin e përbashkët trajnues me temë "Roli i Këshillit të Gjykatës në rritjen e treguesve të performancës, ku u përfaqësua nga Kancelarja Znj. Viola Kondo ku në këtë aktivitet në fokus ishte bashkëpunimi Ekipi drejtues kolegjal, bashkëpunimi Kryetar, nënkryetar dhe kancelar".

14. Seksioni civil dhe Seksioni Penal -30.09.2024

Këshilli i Gjykatës, më datë 20.09.2024 ka disponuar me Vendimin Nr. 67, datë 20.09.2024 "Mbi akomodimin e Dhomës Civile të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe stafit mbështetës, në godinën e ish-Gjykatës së Apelit Durrës, Shkozet", ku ndër të tjera ka vendosur: "TË GJITHA ÇËSHTJET CIVILE QË JANË AKTUALISHT NË SHQYRTIM SI DHE ÇËSHTJET CIVILE TË REGJISTRUARA TË REJA DO TË GJYKOHEN PRANË GODINËS TË ISH-GJYKATËS SË APELIT DURRËS, PREJ DATËS 30.09.2024."

SEKSIONI CIVIL (ish-godina e Gjykatës së Apelit Durrës)

Adresa: Lagja Nr.14, Rruga: "Bajram Tusha", Shkozet, Durrës

Tel: 00355 52 234362

E-mail: zmp.gjykatarrethitdurrës@gjykata.gov.al

SEKSIONI PENAL

- (Godina aktuale e Gjykatës)

Adresa: Lagja Nr. 2, Rruga "Aleksandër Goga", Durrës

Tel: 00355 52 234362

E-mail: zmp.gjykatarrethitdurrës@gjykata.gov.al

Në përfundim, duke vlerësuar se të dhënat e analizuara dhe problematikat e ngritura në këtë analizë pune për vitin 2024 do t'i shërbejnë si trupës gjyqësore, administratës gjyqësore ashtu edhe institucioneve të tjera përkatëse që lidhen me sistemin gjyqësor, dëshiroj të shpreh në emrin tim dhe të trupës gjyqësore të Gjykatës se Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës angazhimin tonë maksimal për rritjen në vijimësi të performancës së kësaj Gjykate.

ZËVËNDËSKRYETAR

PAULIN ÇERA